

39/32

07.12.18.

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Msc.

“E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare”,

ofruar nga Universiteti i New York-ut në Tiranë

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Evis Alimhmeti

Dr. Darinka Piqani

(Dhjetor/2018)



RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Msc. E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti i New York-ut në Tiranë
2	Fakulteti që e ofron:	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit:	VKM Nr. 939, datë 03.09.2009
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë:	UMASH Nr. 170, datë 20.04.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në "E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare"
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni:	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
16	Numri i studentëve:	14 studentë

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Msc. në "E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare"

Mbështetur në VKM Nr. 939, datë 03.09.2009, Shkolla e lartë universitare private "University of New York, Tirana", në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich-it (Britani e Madhe) ka hapur programin e studimit Master i Shkencave në "E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare". Ky program është hapur si program studimi i ciklit të dytë, me kohë të plotë, me emërtimin LL.M. në "E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare" ekuivalente me Diplomë të Nivelit të Dytë (DND). Ky program studimi është licensuar për t'u zhvilluar me kohëzgjatje një vit akademik dhe 60 ECTS dhe në të pranohen të regjistrohen studentë të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të parë me kohëzgjatje 4 vite akademik dhe 240 ECTS.

Me shkresë Nr. 6858/2, datë 06.05.2011, Ministria e Arsimit dhe Shkencës bën me dije se ka marrë njoftim për përshtatjen e programit të studimit në fjalë në Master i Shkencave me kohëzgjatje dy vite akademike dhe 120 ECTS. Me Urdhër Nr. 203, datë 06.05.2011, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka dhënë lejen për ushtrimin e aktivitetit akademik për këtë program si LL.M. në "E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare".

Këshilli i Akreditimit, me vendimin Nr. 323, datë 16.03.2012, dha vlerësimin pozitiv për programin në fjalë dhe dha disa rekomandime për t'u plotësuar nga institucioni për përmirësimin e cilësisë së këtij programi. Konkretisht këto rekomandime janë:

1. Të ndërtohet sa më shpejt një kampus për të patur një shkollë sa më cilësore por edhe me kushte normale për zhvillimin e mësimin.
2. Të vihet theksi më shumë në aspekte të ligjit dhe praktikës Shqiptare, duke përfshirë një trajtim më të zgjeruar të ligjeve shqiptare të lëmvive përkatëse si dhe praktikën e gjykatave.

Mbështetur në Vendimin Nr. 323 të Këshillit të Akreditimit, Ministria e Arsimit me Urdhër Nr. 170, datë 20.04.2012 ka akredituar programin e studimit në fjalë si dhe ka urdhëruar shkollën e lartë universitare të plotësojë rekomandimet e Këshillit të Akreditimit. Në këtë urdhër, ky program studimi është akredituar si Master i Shkencave dhe nuk përmendet lloji LL.M. Gjithashtu, në vendimin e Këshillit të Akreditimit dhe Urdhërin e Ministrisë nuk përmendet nëse ky program vazhdon të ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich-it.

Me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 184, datë 16.05.2013, është bërë regjistrimi i formës së diplomës së këtij programi si Master i Shkencave në "E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare".

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ):

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Dr. Evis Alimehmeti dhe Dr. Darinka Piqani si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga specialistët e ASCAL, Znj. Ersi Dako dhe Z. Erion Xhako.

Më datë 27.11.2018, përmes sistemit AMS, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga ekspertët e vlerësimit. Më datë 03.12.2018 Institucioni, përmes sistemit AMS, përcjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft-RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me komentin e Institucionit mbi punësimet e reja dhe vlerësojnë se ndryshimet e bëra kanë lidhje me fillimin e vitit akademik 2018-2019 dhe janë realizuar pas vizitës së GVJ në Institucion. Komenti i Institucionit vjen edhe si konfirmim i konstatimit të bërë nga ana e ekspertëve dhe pasqyron një hap pozitiv që Institucioni ka ndërmarrë për përmirësimin e numrit dhe kualifikimit të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Sa më lart, GVJ nuk bën ndryshim në Raportin e hartuar.


**ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR
AKKREDITIMIN E PARË**

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

- a) Të ndërtohet sa më shpejt një kampus për të patur një shkollë sa më cilësore por edhe me kushte normale për zhvillimin e mësimin.
- b) Të vihet theksi më shumë në aspekte të ligjit dhe praktikës Shqiptare, duke përfshirë një trajtim më të zgjeruar të ligjeve shqiptare të lëmive përkatëse si dhe praktikën e gjykatave.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

- a) Për rekomandimin "a)", "Të ndërtohet sa më shpejt një kampus për të patur një shkollë sa më cilësore por edhe me kushte normale për zhvillimin e mësimin", GVJ konstaton që institucioni zhvillon aktivitetin e tij në një kampus i cili përmbledh administratën, ambiente për zhvillimin e mësimdhënies, bibliotekën, laboratorë kompjuterikë. **GVJ konkludon se ky rekomandim është plotësuar.**
- b) Për rekomandimin "b)", "Të vihet theksi më shumë në aspekte të ligjit dhe praktikës Shqiptare, duke përfshirë një trajtim më të zgjeruar të ligjeve shqiptare të lëmive përkatëse si dhe praktikën e gjykatave", GVJ konstaton se disa nga lëndët e programit master si Civil Procedural Law, Company Law II, Fiscal Law, Private International Law trajtojnë, sipas specifikave të tyre, aspekte të ligjit dhe praktikës shqiptare. Duke patur parasysh natyrën e programit master në fjalë – me fokus në të drejtën ndërkombëtare - **GVJ konkludon se ky rekomandim është plotësuar.**



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Programi i ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare” ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë dhe i Shkencave Sociale të Universitetit i New York i Tiranës, i hapur me anë të Vendimit Nr. 397, datë 15.06.2002, i Këshillit të Ministrave si Shkollë e lartë Universitare dhe i njohur si Universitet me VKM Nr. 448, datë 11.07.2012. Programi i studimeve Master Shkencor në “E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare” është hapur bazuar në Vendimin Nr. 939, datë 03.09.2009 të Këshillit të Ministrave, dhe është akredituar me Urdhërin Nr. 170 datë 20.04.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Programi i studimeve Master i Shkencave në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare, ofrohet nga departamenti i Drejtësisë dhe i Shkencave Humane i cili ofron gjithashtu edhe program tjetër Master Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare. Departamenti angazhohet në përmbushjen e kërkesave të programit akademik të të dy programeve Master si pjesë e kurrikulës së Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, është në përputhje me planin strategjik të zhvillimit të Institucionit sipas Statutit dhe dokumentave strategjik të së cilit misioni e qëllimi i Institucionit është edukimi dhe zhvillimi i njohurive mbi bazën e kërkimit shkencor dhe në funksion të tyre organizimi i studimeve në të tre ciklet universitare. Programi synon t’i përgjigjet nevojave të tregut për specialistë në fushën e të drejtës ndërkombëtare e asaj tregtare nëpërmjet pajisjes së studentëve me njohuri të avancuara të karakterit shkencor në këto dy degë të rëndësishme të së drejtës.

Duke konsideruar proceset aderuese të vendit, nevoja për profesionistë të informuar përshtatshëm mbi rregullimet e reja në fushën e të drejtës ndërkombëtare por sidomos në atë Tregtare që po njih një zhvillim tejet intensiv në kuadër të rregullimeve të tregut nën parimet e të drejtës së BE-së është e madhe.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:
- Memorandum of Agreement UNYT – Greenwich, 2010
 - Memorandum of Agreement UNYT – Greenwich, 2014

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit; Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit; Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Referuar Statutit të Institucionit në nenin 5 të tij identifikohen ndërmjet të tjerave si mision e qëllime të Institucionit edukimi dhe zhvillimi i njohurive mbi bazën e kërkimit shkencor dhe në funksion të sa më sipër organizimin e studimeve në të tre ciklet universitare. Gjithashtu, programi i studimit Master Shkencor në fushën e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Tregtare sipas parashikimeve në Handbook of Rules të programit synon ofrimin e njohurive e studimeve të thelluara në fushën e të drejtës ndërkombëtare dhe tregtare duke e konsideruar si një fushë të së drejtës me një zhvillim shumë të shpejtë. Sipas objektivave të programit synohet të përgatitet një larmishmëri profesionistësh në këtë fushë duke përfshirë profesionistët e praktikës, ata të sektorit të administratës publike, akademikët që dëshirojnë të

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

	<p>zgjerojnë njohuritë në fushë, etj. Qasja e programit është krahasimore në drejtim të së drejtës së BE-së dhe asaj të SHBA-së dhe gjithashtu të së drejtës në nivelin ndërkombëtar. Zhvillimet në fushën e të drejtës ndërkombëtare sidomos asaj të BE-së dhe gjithashtu edhe në atë të biznesit megjithëse përbën një degë studimi më vete në raport me të drejtën ndërkombëtare, janë të rëndësishme në drejtim të studimit të thelluar veçanërisht në kuadër të proceseve aderuese të Shqipërisë dhe nevojës për njohuri të thelluara në drejtim të kërkesave që shoqërojnë këtë proces. Në raport me kërkesat e tregut të punës sipas edhe një policy paper që përmban dokumentacioni i dorëzuar nga Institucioni dhe nëpërmjet diskutimeve me përfaqësues të tij, rezultoi se ka një vëmendje ndaj kërkesave të tregut megjithëse jo e formalizuar në sondazhe apo analiza formale të përgjigjes së tregut ndaj objektivave të programit.</p> <p>Edhe pse ruajtja e vlerave kombëtare mund të identifikohet jo drejtpërdrejt, duke ju referuar analizës së syllabuseve, programi i studimit synon të ndihmojë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Referuar dokumentit Planit Strategjik të institucionit për 2018-2022 por edhe Planit Strategjik 2013-2017, evidentohet se ndër qëllimet strategjike të Institucionit si në planin 2012-2017 ashtu edhe për 4 vitet e ardhshme janë zgjerimi dhe mbështetja e Agjendës së Institucionit për Kërkimin Shkencor dhe arritjen e rezultateve si dhe arritja e ekselencës në mësimdhënie dhe në shërbime. Këto objektiva veçanërisht ai i kërkimit shkencor dhe arritjes së rezultateve shtrihet ndaj të gjitha fakulteteve përfshirë edhe atë të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale brenda të cilit ofrohet dhe programi i studimit Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare. Qëllimet strategjike nuk zbërthejnë në mënyrë të posaçme zhvillimin e kërkimit shkencor në kuadër të hulumtimit shkencor që angazhon tipikisht një program studimesh të thelluara i ciklit të dytë siç është ai pasuniversitar Master; sidoqoftë mund të thuhet se në tërësi rezultoi në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. Programi i studimit Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare i zhvillon këto objektiva duke synuar kualifikimin e studentëve në bazë të profilizimit të tyre në fusha të posaçme të së drejtës, avancimit në fushën e shkencës nëpërmjet përgatitjes për të zhvilluar hulumtim shkencor inovativ e gjithmonë në progres në funksion të nxënies së tyre, etj.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	

<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Në lidhje me përmbajtjen e programit, shtrirja e përmbajtjes në 2 degë të së drejtës (ndërkombëtare dhe tregtare) është e papërshtatshme në qasjen e studimit të tyre të përbashkët. Programi duhet të japë hapësirën e nevojshme të studimit ose të së drejtës ndërkombëtare ose të së drejtës ndërkombëtare tregtare. Në qasjen që ka, përveç papërshtatshmërisë së realizimit të studimit në dy degë të ndryshme të së drejtës ka dhe potencialin e mos ezaurimit të studimit të thelluar të asnjërës prej tyre.</p> <p>Përtej sa më sipër, programi në përgjithësi është në përshatshmëri në lidhje me parimet e kuadrit të ri rregullator të arsimit të lartë, parimet e organizimit të cikleve sipas Kartës së Bolognës.</p> <p>Sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit, programi Master Shkencor në fushën e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Tregtare lidhet me nivelin 7 të Kornizës.</p>
--	--

Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Institucioni ka një Plan Strategjik 4 vjeçar 2018-2022 që pason Planin Strategjik të 2012-2017; të dyja dokumentat (të cilat nga ana formale duhet të përmbanin datën e miratimit zyrtar nga ana e Institucionit) megjithëse nuk kanë në fokus të posaçëm strategjinë e zhvillimit të studimeve të thelluara në ciklin e dytë të studimeve, përfshijnë objektiva në drejtim të kërkimit shkencor dhe ndjekjes së zhvillimeve në rajon, BE dhe të drejtë ndërkombëtare. Në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies, Planet Strategjike e kanë në vëmendje nxitjen dhe përmirësimin e saj duke synuar gjithmonë ekselencën akademike, zhvillimin e profilit shkencor të lektorëve, sidomos edhe në drejtim të përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe qëndrimit pranë studentit në përgjigje të nevojave të nxënies, zhvillimit të metodave vlerësuese të performancës së lektorëve në disa nivele, matjen e përgjigjes së tregut në lidhje me cilësinë e përgatitjes së studentëve.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Referuar Statutit dhe Planeve Strategjike të Institucionit, ndër misionet e qëllimet të Institucionit janë edhe edukimi dhe zhvillimi i njohurive mbi bazën e kërkimit shkencor dhe në funksion të sa më sipër organizimin e studimeve në të tre ciklet universitare. Qëllimet strategjike nuk zbërthejnë në mënyrë të posaçme zhvillimin e kërkimit shkencor në kuadër të hulumtimit shkencor që angazhon tipikisht një program studimesh të thelluara i ciklit të dytë siç është ai në nivelin Master Shkencor; sidoqoftë mund të thuhet se në tërësi rezultojnë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.
2. Institucioni ka një Plan Strategjik 4 vjeçar 2018-2022 që pason Planin Strategjik të 2012-2017; Planet Strategjike e kanë në vëmendje nxitjen dhe përmirësimin e saj duke synuar gjithmonë ekselencën akademike, zhvillimin e profilit shkencor të lektorëve, sidomos edhe në drejtim të përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe qëndrimit pranë studentit në përgjigje të nevojave të nxënies, zhvillimit të metodave vlerësuese të performancës së lektorëve në disa nivele, matjen e përgjigjes së

tregut në lidhje me cilësinë e përgatitjes së studentëve.

3. Përmbajtja e programit është në përshtatshmëri në lidhje me parimet e kuadrit të ri rregullator të arsimit të lartë, parimet e organizimit të cikleve sipas Kartës së Bolognës.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Sic dhe parashikohet në nenin 18 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”², Institucioni ka në përbërje të strukturës së tij akademike tre fakultete si më poshtë:

1. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale (më parë quhej “Fakulteti i Drejtësisë, Artit dhe Shkencave”);
2. Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit;
3. Fakulteti i Informatikës.

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, sipas kërkesave të nenit 23 të Ligjit për Arsimin e Lartë, përbëhet nga dy Departamente dhe një Qendër si më poshtë:

1. Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane;
2. Departamenti i Shkencave Sociale;
3. Qendra kërkimore për Shkencat Sociale.

Programi i studimit në fjalë ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale.

Statuti i IAL-së në fjalë mban datën Prill 2017 dhe në nenin 9 reflekton të njejtën strukturë akademike. Në bazë të nenit 11 të Statutit, Senati Akademik, si organi kolegjal më i lartë, drejtohet nga Rektori dhe mbidhet në mënyrë periodike. Në bazë të nenit 12 të Statutit, Senati orienton dhe mbështet politikat strategjike akademike të Institucionit. Në bazë të nenit 13 të Statutit, Senati përbëhet nga Rektori, dymbëdhjetë anëtarë nga njësitë kryesore si dhe një student i zgjedhur nga Këshilli i Studentëve.

Dekani (i Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale), në bazë të nenit 17 të Statutit, emërohet dhe shkarkohet nga Bordi Administrativ i Institucionit bazuar në propozimin e Rektoratit dhe miratimin e Senatit Akademik. Sipas të njëjtit nen të Statutit, Dekani i Fakultetit duhet të ketë titullin “Profesor”. Në bazë të nenit 18 të Statutit, Dekani i Fakultetit është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Ndër të tjera Dekani, drejton Këshillin e Fakultetit, mbikqyr zbatimin e procedurave të Institucionit nga stafi i Fakultetit, koordinon programin akademik duke vlerësuar përmbajtjen e programit, merr pjesë në rekrutimin e stafit akademik, merr pjesë në Rektorat dhe organe të tjera të universitetit etj. Këshilli i Fakultetit kryesohet nga Dekani dhe përbëhet nga Zv. Dekani, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë, një anëtar nga stafi jo-akademik, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve.

Në bazë të nenit 21 të Statutit, Departamenti dhe Qendra Kërkimore Shkencore janë njësitë akademike bazë për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Në bazë të nenit 22 të Statutit – i cili reflekton nenin 25 të Ligjit për Arsimin e Lartë, Departamenti përbëhet nga të paktën shtatë anëtarë të punësuar më kohë të plotë si personel akademik, nga të cilët të paktën tre duhet të kenë grada shkencore ose tituj akademike. Në bazë të nenit 23 të

² Referuar si “Ligji për Arsimin e Lartë”



Statutit, që reflekton nenin 45 të Ligjit për Arsimin e Lartë, drejtuesi i Departamentit, mban titullin "Profesor" ose "PhD" nga një universitet të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Drejtuesi i Departamentit, ndër të tjera, zhvillon strategjinë e Departamentit, përgatit shpërndarjen e ngarkesës mësimore, mbikqyr mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, merr pjesë në rekrutim të stafit akademik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Siç është paraqitur dhe në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) si dhe sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në Institucion, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale ka në përbërje të tij dy departamente dhe një Qendër. Secili nga departamentet dhe Qendra përbëhen nga të paktën 7 anëtarë personelit akademik efektiv (PAE), nga të cilët minimumi 3 kanë grada shkencore ose tituj. (Për më shumë shih Tabelat 1 dhe 1.1). Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi një takim me Dekanan e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe Drejtuesen e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane. GVJ konstaton se Dekania e Fakultetit nuk është më titullin "Profesor" siç kërkon neni 42 i Ligjit për Arsimin e Lartë.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës


Për vitin akademik 2017-2018, Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane kishte në përbërje të tij 7 anëtarë PAE prej të cilëve 3 me gradën "Doktor", 1 Doktorant dhe 3 të nivelit Master Shkencor ose LLM. Personeli akademik me kontratë për të njejtën periudhë përbëhej nga 9 anëtarë, prej të cilëve 2 të kategorisë "Profesor", 2 të kategorisë "Profesor i Asociuar", 3 me gradën "Doktor" dhe 2 të nivelit Master Shkencor ose LLM. (Shih Tabelat 1, 1.1, 2)

Për vitin akademik 2016-2017, Departamenti i Shkencave Humane dhe Shkencave Sociale kishte në përbërje të tij 8 PAE prej të cilëve një me titullin "Profesor i Asociuar", 5 me gradën "Doktor", dhe 2 Doktorantë. Personeli akademik me kontratë për të njejtën periudhë përbëhej nga 8 anëtarë, një "Profesor i Asociuar", 4 me gradën "Doktor", 1 Doktorant dhe 2 të nivelit Master Shkencor.


Gjatë vizitës dhe takimit me Dekanan e Fakultetit dhe Drejtuesen e Departamentit, GVJ konstatoi se drejtuesja e Departamentit është me gradën "Doktor" sipas kërkesave të nenit 45 të Ligjit për Arsimin e Lartë.

Po të shohim të dhënat e planit mësimor lidhur me personelin akademik të departamentit ndër vite dhe që ka marrë pjesë në programin e studimit në fjalë, rezultojnë se në disa lëndë, lektorët përgjegjës janë staf me gradën "Doktor" ose titullin "Prof. Asoc" dhe "Prof", në lëndë të tjera ka një kombinim të lektorëve përgjegjës doktorant dhe atyre me grada dhe tituj, ndërsa në disa lëndë të tjera lektorët përgjegjës kanë titullin "LLM" ose master shkencor. Për shembull, për vitin 2017-2018 rezultojnë se për disa lëndë si "Principles of International and Commercial Law", "Public International Law I" ka patur një kombinim të lektorëve përgjegjës me titullin "Prof. Asoc" dhe doktorantë. Por p.sh lënda "Corporate Law II" është dhënë nga një doktorante ndërsa lëndët "Alternative Dispute Resolution" ose "Public International Law II" janë dhënë nga staf me "LLM". Në mënyrë të ngjashme, për vitin 2016-2017 "Civil Procedures", "Foundations of Post Graduate Studies", "Corporate Law I" janë dhënë nga doktorantë. Në vitin 2015-2016 lënda "Corporate Law II" është dhënë nga staf me "LLM". Në vitin 2014-2015 lëndët "Principles of International and Commercial Law", "Foundation of Post Graduate Studies", "Research Methods Law", "Public International Law", "Corporate Law II" janë dhënë nga staf me "LLM". Raste të ngjashme gjenden dhe në vitin akademik 2013-2014 dhe 2012-2013. (Për më shumë shih Tabelat 14.1; 14.2; 14.3; 14.4; 14.5; 14.6). Kjo praktikë e konstatuar nuk është në përputhje të plotë me nenin 59(6) të Ligjit për Arsimin e Lartë i cili parashikon që "Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës." Kjo çështje do trajtohet në vijim në Rubrikën 3 "Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit".

Vlerësimi sipas Standardeve



Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Në bazë të nenit 5 të Statutit, Institucioni ka për qëllim dhe mision edukimin dhe zhvillimin e njohurive mbi bazën e kërkimit shkencor. Sa më sipër do realizohet me organizimin e studimeve në të tre ciklet universitare. Sipas Rregullores së programit të studimit Master Shkencor në fushën e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Tregtare, synohet të ofrohen njohuri dhe studime të thelluara në fushën e të drejtës ndërkombëtare dhe tregtare me qëllim përgatitjen e profesionistëve duke përfshirë profesionistët nga praktika, administrata publike, akademike.</p> <p>Për të përmbushur këtë mision dhe qëllim, Institucioni ka në përbërje të tij tre fakultete nga të cilët, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale përbëhet nga Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane, Departamenti i Shkencave Humane dhe Qendra Kërkimore për Shkencat Sociale.</p> <p>Sipas të dhënave të vitit akademik 2016-2017 dhe 2017-2018, Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane ka patur dhe vazhdon të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë, nga të cilët të paktën 3 kanë qenë me gradën shkencore "Doktor".</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Fakulteti dhe Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane janë përgjegjës për realizimin e programit të studimit. Dekani i Fakultetit, si autoriteti më i lartë i njësisë kryesore, drejton Këshillin e Fakultetit, mbikqyr zbatimin e procedurave të Institucionit nga stafi i Fakultetit, koordinon programin akademik duke vlerësuar përmbajtjen e programit, merr pjesë në rekrutimin e stafit akademik, merr pjesë në Rektorat dhe organe të tjera të universitetit. Drejtuesi i Departamentit, ndër të tjera, menaxhon aktivitetin e njësisë bazë, është përgjegjës për zhvillimin e strategjisë së Departamentit, përgatit – në bashkëpunim me Dekanin dhe Rektorin - programet e lëndëve dhe shpërndarjen e orëve të mësimdhënies tek lektorët, kontrollon aktivitetet e kërkimit shkencor dhe mësimdhënies etj.</p> <p>Në bazë të nenit 24 të Statutit, Drejtuesi i Departamentit përcakton nevojat e Departamentit për staf të ri, koordinon këtë proces me Rektorin dhe</p>




Dekanin si dhe merr pjesë në vlerësimin e kandidatëve. Përfshirja e Departamentit në rekrutimin e personelit akademik u konfirmua dhe nga takimi me përfaqesuesen e Zyrës së Burimeve Njerëzore e cila konfirmoi se nevojat përcaktohen brenda Departamentit, i cili përcakton dhe kriteret, të cilat më pas i kalohen kësaj zyre. Dekani dhe drejtuesi i departamentit janë pjesë të komisionit *ad hoc* që ngrihet për rekrutimin e stafit akademik.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ka në përbërje të tij tre fakultete nga të cilët, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale përbëhet nga Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane, Departamenti i Shkencave Humane dhe Qendra Kërkimore për Shkencat Sociale. Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane ka në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë, nga të cilët të paktën 3 kanë qenë me gradën shkencore "Doktor". Dekania e Fakultetit nuk është me titullin "Profesor" siç kërkon neni 42 i Ligjit për Arsimin e Lartë. Drejtuesja e Departamentit është me gradën "Doktor" sipas kërkesave të nenit 45 të Ligjit për Arsimin e Lartë.
2. Fakulteti dhe departamenti me drejtuesit përkatës përfshihen në realizimin e programit të studimit si dhe në procesin e rekrutimit të stafit akademik. Drejtuesi i Departamentit përcakton nevojat e Departamentit për staf të ri, koordinon këtë proces me Rektoren dhe Dekanin si dhe merr pjesë në vlerësimin e kandidatëve.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Fakulteti i Drejtësisë dhe i Shkencave Sociale është i organizuar në 3 njësi bazë, Departamenti i Drejtësisë dhe i Shkencave Humane, Departamenti i Shkencave Sociale dhe Qendra Kërkimore për Shkencat Sociale sipas parashikimeve në Statutin e Institucionit. Departamenti i Drejtësisë dhe i Shkencave Humane i cili ofron Programin Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare ofron gjithashtu edhe program tjetër Master Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare. Personeli akademik efektiv (PAE) dhe anëtarë personeli akademik me kontratë (PAK) i Departamenti angazhohet në përmbushjen e kërkesave të programit akademik të të dy programeve Master.

Departamenti në vite ka ndryshuar kompozimin e anëtarëve personeli akademik efektiv (PAE) dhe anëtarë personeli akademik me kontratë (PAK).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Në vitin akademik 2017-2018 sipas të dhënave nga institucioni, Departamenti ka angazhuar në total 7 anëtarë PAE, nga të cilët 3 me gradën shkencore Doktor i Shkencave, 3 anëtarë me diplomë studimesh Master Shkencor dhe 1 doktorant. Gjithashtu janë angazhuar edhe 7 anëtarë personeli me kontratë (PAK) përkatësisht 2 me titullin Prof. Dr., 2 me titullin Prof. Asoc. dhe anëtarë me gradën shkencore Doktor i Shkencave. Angazhimi i personelit PAE dhe PAK për vitet e tjera akademike janë si më poshtë:



Bazuar në të dhënat e vitit më të fundit akademik 2017-2018, personeli akademik efektiv i angazhuar për realizimin e programit Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare është në një raport të përshtatshëm me kërkesën për angazhimin në masën 70% të numrit total të anëtarëve të personelit të angazhuar në program (5 PAE në raport me 2 PAK) dhe mbulimit të ngarkesës së programit Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare në masën 70% për vitin 2017-2018. Specifikisht 86.7 % e ngarkesës së përgjithshme mbulohet nga PAE dhe 13.3 % nga PAK. Sidoqoftë duhet theksuar që kjo përqindje arrihet duke pasur të njëjtët titullarë të brendshëm në 2-3 lëndë të programit. Në vitin akademik 2016-2017, për brezin e 8-të të studentëve (16-18) PAE mbulon 68,3 % të ngarkesës së përgjithshme të programit të studimit dhe PAK mbulon 31.7 % të ngarkesës, ndërsa për brezin e 9-të të studentëve (17-19), PAE mbulon 75 % të ngarkesës së përgjithshme dhe PAK mbulon 25 % të ngarkesës. Në vitin akademik 2015-2016, PAE mbulon 75 % të ngarkesës së përgjithshme të programit të studimit ndërsa PAK mbulon 25 %. Në këto vite akademike qëndron i njëjti tipar i angazhimit të të njëjtit ekip dhe të njëjtit titullar në disa lëndë.

Në vitin akademik 2016-2017 raporti është 4 PAE me 4 PAK (në aspektin numerik 50 % me 50 %); në 2015-2016 raporti është 5 PAE me 6 PAK (në aspektin numerik 45.5 % me 54.5 %). Ka një problematikë të ndjeshme në drejtim të përbushjes së kriterëve për gradat e titujt të personelit që angazhohet në mesimdhënie në programin Master; ka një angazhim deri në nivel titullarësh të lëndëve të personelit të brendshëm e të jashtëm që ka vetëm gradën Master Shkencor. Më shumë së gjysma e personelit të angazhuar në programin Master nuk zotërojnë së paku gradën Doktor Shkencash (për vitin 2017-2018 rezultojnë 4 titullarë (nga 7 në total) që nuk zotërojnë së paku gradën Doktor i Shkencave; në 2016-2017 rezultojnë 5 titullarë pa gradë shkencore nga 8 në total; në 2015-2016 rezultojnë 5 titullarë nga 11 titullarë pa gradë shkencore, etj).

Institucioni është në përpjekje për të arritur këtë objektiv. Gjithashtu pranë programit asistojnë 7 anëtarë personeli staf administrative, një numër i qëndrueshëm në vite pranë programit.

Rekrutimi i personelit akademik bëhet në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës për njoftimin, procedurën e rekrutimit, lidhjen e kontratës e termat e saj, etj. Rregulla mbi mënyrën e përcaktimit të nevojave për punësim, autoriteteve që përcaktojnë kriteret, ngritjen e komisioneve ad-hoc e kompozimin e tyre gjenden edhe në Statutin dhe Rregulloren e Institucionit. Rekrutimi i punonjësve të rinj bëhet mbi bazën e kriterëve dhe procedurave të parashikuara në Statutin dhe në rregulloren e brendshme të institucionit. Përparësi i jepet personelit më të kualifikuar në tituj e grada dhe edukim në universitete të huaja.


Të dhëna të plota në lidhje me moshën, gradat e titujt sipas kategorive, janë pasqyruar në tabelat 5, 6.1, 6.2, 6.3, në Aneksin e Reportit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:


- Plani mësimor i lidhur me stafin akademik, i ndarë sipas viteve akademike (përfshirë tek tabelat në word)
- CV e pedagogëve: B. F; A K; A. Zh
- Kontratë I.P (pranverë 2015)
- Kontratë I.P (pranverë 2016)
- Faculty Selection Committee Meeting
- Faculty Selection Criterias and Procedures

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	




<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit përgjithësisht angazhohet në përputhje me objektivat e programit duke pasur në vëmendje profilin dhe ekspertizën në disiplinën ku angazhohet. Një pjesë e personelit akademik angazhohet në mësimdhënie pa pasur nivelin e kërkuar të kualifikimit sipas akteve në fuqi, që mund të ndikojë në masën e përmbushjes së objektivave të programit të studimit.</p> <p>Do duhet që angazhimi në nivelin Master Shkencor të lidhet në të gjitha nivelet me kualifikimin Doktor i Shkencave e sipër.</p>
<p>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Në bazë të informacionit të marrë drejtpërsëdrejti në takimet me anëtarë të personelit akademik të programit rezulton se përgjegjësia kryesore në hartimin e kurrikulës qëndron tek personeli akademik i njësisë bazë.</p> <p>Sidoqoftë, në Statutin e Universitetit të miratuar në 2017 ka parashikime për kompetencat e drejtuesit të Departamentit por mungojnë parashikimet për rolin dhe detyrat e Departamentit dhe vendimmarrjet e tij kolegjiale në drejtim të programeve që ofron si njësi akademike e shkencore përgjegjëse për këto programe.</p> <p>Ndër kompetencat e Drejtuesit të Departamentit në Statut parashikohet edhe përgatitja e programeve të kurseve në bashkëveprim me Dekanin dhe Rektorin e Institucionit duke mos specifikuar nëse ky rol është vetëm në fazën përfundimtare të procesit dhe sidomos pa rregulluar rolin e lektorit në hartimin e kurrikulës së lëndës përkatëse dhe vendimmarrjes së Departamentit si njësi bazë akademike e shkencore. Sipas Statutit, një rregullore e veçantë për të drejtat e personelit akademik do të hartohet më tej në kohë, ndërkohë që të drejtat e personelit akademik sidomos në drejtim të lirive akademike dhe shkencore duhet të përfshihen në norma themelore në Statutin e Institucionit. Po kështu Statuti përmban parashikime në lidhje me kompetencat e Këshillit të Fakultetit në lidhje me miratimin e programeve të reja të studimit sipas fushave të departamenteve por nuk ka parashikime se cili është roli i departamentit në këtë proces.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	




Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;


Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.


Rekrutimi i personelit akademik rregullohet në drejtim të procedurave për rekrutim në Statutin e institucionit, nenet 38-41. Statuti përmban parashikime edhe për procedurën e rekrutimit të personelit ndihmës dhe atij administrativ. Nga takimi me stafin dhe konsultimi i dokumentacionit, përparësi i jepet personelit të kualifikuar sidomos në universitete të huaja, sidomos edhe për shkak të kriterit të njohjes së gjuhës angleze për qëllime të mësimdhënies. Në lidhje me procesin e rekrutimit ka një rregullim të posaçëm për kriteret dhe procedurat e rekrutimit. Institucioni ka edhe rregullore mbi procesin e rekrutimit, megjithëse nuk është e qartë se kush e ka aprovuar: në përgjithësi në të gjitha dokumentacionin e programit mungon informacioni mbi subjektin aprovues dhe fuqinë e tyre, nuk përmbajnë firmë e vulë. Kontrata e punës është e organizuar në pjesë, duke përshkruar lëndët në të cilët do të angazhohet personeli, të drejtat dhe përgjegjësitë, pasojat, mënyrën e zgjidhjes së kontratës, etj.

Në disa vite kontratat kanë një rregullim më të shkurtër duke mos përfshirë informacion të saktë mbi numrin e orëve të angazhimit të personelit dhe përgjegjësitë përkatëse.


Bazuar në të dhënat e vitit më të fundit akademik 2017-2018, personeli akademik efektiv i angazhuar për realizimin e programit Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare është në një raport të përshtatshëm me kërkesën për angazhimin në masën 70% të numrit total të anëtarëve të personelit të angazhuar në program (5 PAE në raport me 2 PAK- 71.4 % PAE dhe 28.6 % PAK) dhe mbulimit të ngarkesës së programit Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare në masën 70% për vitin 2017-2018. Në këtë vit akademik, PAE mbulon 86.7 % të ngarkesës së përgjithshme të programit të studimit ndërsa PAK mbulon 13.3 %. Sidoqoftë duhet theksuar që kjo përqindje arrihet duke pasur të njëjtët titullarë të brendshëm përkatësisht në disa lëndë të programit. Në vitin akademik 2016-2017, raporti numerik është 4 PAE me 4 PAK (50 % me 50 %). Përsa i përket ngarkesës, për brezin e 8-të të studentëve (16-18) PAE mbulon 68,3 % të ngarkesës së përgjithshme të programit të studimit dhe PAK mbulon 31.7 % të ngarkesës, ndërsa për brezin e 9-të të studentëve (17-19), PAE mbulon 75 % të ngarkesës së përgjithshme dhe PAK mbulon 25 % të ngarkesës. Në vitin akademik 2015-2016, raporti numerik është 5 PAE me 6 PAK (45.5 % me 54.5 %). Përsa i takon ngarkesës, PAE mbulon 75 % të ngarkesës së përgjithshme të programit të studimit ndërsa PAK mbulon 25 %. Në këto vite



	<p>akademike qëndron i njëjti tipar i angazhimit të të njëjtit ekip dhe i të njëjtëve titullarë në disa lëndë.</p> <p>Institucioni gjithashtu ka një sistem procedurash të përshtatshme për vlerësimin e personelit; vlerësimi realizohet në tre nivele, nga studentët, nga <i>peers</i> përfshirë edhe vetëvlerësimin nga ana e vetë anëtarit të personelit në vlerësim dhe një monitorim vjetor në rang departamenti që bazohet në të dhënat e mbledhura nga vlerësimet e bëra gjatë vitit. Institucioni ka gjithashtu një rregullore udhëzuese miratuar në mars të 2018 nga Senati i Universitetit, mbi mënyrën e realizimit të promovimit të anëtarëve të personelit akademik bazuar në një vlerësim performance për qëllime të promovimit akademik që fillon nga Departamenti e përmbyllet me vlerësimin e Rektorit, me të drejtën për apelim. Shefi i departamentit dhe dekani i nënshtrohen gjithashtu vlerësimit por në nivel rektorati.</p> <p>Sipas komunikimeve në takimet në Institucion, vlerësimi realizohet gjithashtu nga drejtuesi i njësisë bazë por edhe në nivel Fakulteti e Rektorati nëpërmjet pjesëmarrjes në auditore të personelit akademik. Gjithashtu institucioni përshin një sistem vlerësimi të mënyrës së realizimit të procesit vlerësimi të përfundimtar në lëndë të studentëve, procedurë që kalon nga Shefi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit. Insitutucioni ka miratur model formularësh vlerësimi për gjithë sa më sipër. Rubrikat e formularëve përfshijnë disa aspekte si mësimdhënia, kërkimi shkencor, apo kontributi institucional, në projekte, etj.</p> <p>Institucioni mban një bazë të përshtatshme të të dhënave të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj. ose postuniversitare jashtë vendit. Institucioni publikon vendet vakante dhe kriteret përkatëse në web site. Përdoret vlerësimi i bazuar në sistem pikëzimi.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe</p>	<p>Përgjegjësi i programit Master Shkencor ka gradën PHD. Sidoqoftë ka një problematikë të ndjeshme në drejtim të përmbushjes së kriterëve për gradat e titujt të personelit që angazhohet në mësimdhënie në programin Master; ka një angazhim deri në nivel titullarësh të lëndëve të personelit të brendshëm e të jashtëm që ka vetëm gradën Master Shkencor. Më shumë së gjysma e personelit të angazhuar në programin Master nuk zotërojnë së paku gradën Doktor Shkencash. Për vitin 2017-2018 rezultojnë 4 titullarë (nga 7 në total) që nuk zotërojnë së paku gradën Doktor i Shkencave, në 2016-2017 rezultojnë 5 titullarë pa gradë shkencore nga 8 në</p>




<p>një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>total në 2015-2016 rezultojnë 5 titullarë nga 11 titullarë pa gradë shkencore etj. (Të dhënat për çdo vit ndodhen në Aneksat e Raportit).</p> <p>Rektori, Zv/rektori, drejtori dhe Zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, Dekani, Zv/dekani, Drejtori, Përgjegjësi i Departamentit, Koordinatorja e programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve. Në drejtim të praktikave, profesionale programi Master Shkencor në “E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare” mund të thuhet se ka personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Nga takimet me studentët drejtpërsëdrejti dhe konsultimit me aktet e brendshme rezulton se studentët që ndjekin programin Master Shkencor në “E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare” kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës të cilin e identifikojnë në fillim të vitit të dytë të studimeve. Sipas të dhënave të konsultuara udhëheqësit janë zakonisht nga personeli që zotëron së paku gradën shkencore “Doktor”. Nga konsultimet me studentët dhe Përgjegjësen e Departamentit si dhe vëzhgimi i punimeve të depozituara në Bibliotekë rezulton se kufiri i numrit 5 është i aplikueshëm kjo dhe për shkak të numrit të ulët të studentëve të programit çdo vit (10 ose më pak se 10 studentë, vetëm 1 vit akademik me 13 studentë).</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Sipas informacionit të marrë në institucion dhe listës së pedagogëve në drejtim të praktikës mund të thuhet se njësia është e vëmendshme në shpërndarjen e pedagogëve mbikëqyrës të temave të kërkimit sipas fushës studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit e është parashikuar të hartohet teza.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga vizita në Institucion mund të thuhet se Institucioni ka një angazhim të përshtatshëm të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve të tilla si kërkim i pavaruar burimesh nëpërmjet sistemit online të bibliotekës. Studentët asistohen nga stafi i bibliotekës nën drejtimin e punës nga lektori i lëndës.</p>




Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

Sipas informacionit të marrë në institucion e në konsultim me kontratat e punës rezulton që në lidhje si me personelin akademik të brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm ndiqen rregullime të veçanta jo sipas rregullimeve të Udhëzimit Nr. 20, i datës 09.05.2008 i Ministrisë të Arsimit.

Sipas komunikimeve në Institucion kjo qasje do të vazhdojë edhe në vitet në vijim bazuar edhe në Udhëzimin e ri Nr. 9, datë 10.09.2018, i cili në pikën 5 të tij parashikon të drejtën e IAL jo publike për përcaktimin e ngarkesës minimale nga vetë institucioni. Stafit i brendshëm sipas komunikimeve me anëtarët e personelit akademik dhe konsultimit të kontratave përkatëse qëndron minimalisht në limitin e 200 orëve mësimore në auditor, dhe aktivite të tjera mbi këtë ngarkesë, kurse personeli i jashtëm sipas orëve të vendosura në kontratë të cilat nuk kanë përcaktim të qëndrueshëm në çdo kontratë.

Sidoqoftë, në konsultim me orarin e lëndëve dhe komunikimet me studentët e programit rezultojnë një angazhim në auditor në 3 ditë të javës në 3-4 orë sipas studentëve; sipas komunikimeve të institucionit mësimi zhvillohet ditëve të enjte/premte nga 4 orë respektivisht dhe të shtunave 8 orë duke arritur numrin 16 orë/javë për lëndët me 8 kredite sipas planprogramit (tabela 12 e Aneksëve).

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;


Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Institucioni disponon bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Gjithashtu, disponohet për secilin semestër lista e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.

Në drejtim të kriterëve dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik, ato janë të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren për Rekrutimin e Personelit Akademik. Thirrjet janë publike në përmbushje të kërkesave të kuadrës ligjore në fushën e arsimit të lartë dhe kërkesave të Kodit të Punës.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit përgjithësisht angazhohet në përputhje me objektivat e programit dhe në drejtim të procesve të rekrutimit, vlerësimit periodik dhe mbështetjes nga personeli ndihmës shkencor por më shumë së gjysma e personelit të angazhuar në programin Master nuk zotëron së paku gradën Doktor Shkencash, sipas kërkesave të akteve në fuqi, që mund të ndikojë në masën e përmbushjes së objektivave të programit të studimit.
2. Personeli akademik efektiv i angazhuar për realizimin e programit Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare është në një raport të përshtatshëm me kërkesën për angazhimin në



masën 70% të numrit total të anëtarëve të personelit të angazhuar në program dhe mbulimit të ngarkesës së programit Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare në masën 70% (86.7 %), por kjo përqindje arrihet duke pasur të njëjtët titullarë të brendshëm në disa lëndë të programit. Në vitin akademik 2016-2017, për brezin e 8-të të studentëve (16-18) PAE mbulon 68,3 % të ngarkesës së përgjithshme të programit të studimit, ndërsa për brezin e 9-të të studentëve (17-19), PAE mbulon 75 % të ngarkesës së përgjithshme. Në vitin akademik 2015-2016 PAE mbulon 75 % të ngarkesës së përgjithshme. Edhe në këto vite akademike qëndron i njëjti tipar i anagzimit të të njëjtit ekip dhe i të njëjtëve titullarë në disa lëndë.

3. Mungon një rregullim i qëndrueshëm i orëve të vendosura në kontratë të cilat nuk kanë përcaktim të qartë për qëllime të referencës në Planprogramin e lëndëve.
4. Në Statutin e Universitetit mungojnë parashikimet për rolin dhe detyrat e Departamentit dhe vendimmarrjet e tij kolegjiale në drejtim të programeve që ofron si njësi akademike e shkencore përgjegjëse për këto programe, sidomos roli i lektorit në hartimin e kurrikulës së lëndës përkatëse dhe vendimmarrjes së Departamentit si njësi bazë akademike e shkencore. Mungojnë rregullime për të drejtat dhe liritë akademike të personelit akademik.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore


Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Sipas RVB (fq. 37) nga viti 2015 Institucioni ka kampusin e ri qendror që ndodhet te Kodra e Diellit. Ky kampus, i cili i shtohet ndërtesës ekzistuese në rrugën Komuna e Parisit ndërtuar në 2002, është në dispozicion të Institucionit me qëllim përmbushjen e rekomandimit të Këshillit të Akreditimit me vendimin Nr. 323, datë 16.03.2012. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e cila ka 40 vende për lexim dhe një fond me libra kryesisht në gjuhën angleze. Përballë bibliotekës gjendet salla me kompjutera dhe fotokopje. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ vizitoi bibliotekën, zyrën e Rektorit, sekretarinë mësimore, zyrën e pranimeve, një sallë mbledhjesh, klasa, salla leksionesh.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit (Për më shumë shih Tabelën 7.1)
- Salla për leksione
 - Klasa për seminare
 - Salla për aktivitete promovuese
 - Salla për praktikë lëndore/ profesionale
 - Laboratorë për lëndët
 - Laboratorë informatike
 - Salla interneti
 - Salla për bibliotekë
 - Mjedis për fotokopjime, librari etj
 - Zyrë informacioni për studentët
 - Nyje hidrosanitare

- Mjediset për stafin (Për më shumë shih Tabelën 7.2)



- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Nga viti 2015 Institucioni zhvillon aktivitetin e tij në një kampus me vendndodhje të përhershme që përfshin zyrat për administratën dhe mjediset për mësimdhënien.

GVJ vizitoi vetëm kampusin e ri ku zhvillohet e gjithë veprimtaria akademike dhe administrative e Institucionit. Biblioteka është ngritur në nivel institucioni dhe në të ndodhen ambiente leximi me 40 vende. Biblioteka shërben nëpërmjet literaturës fizike dhe asaj elektronike. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ verifikoi ambientet e bibliotekës e cila ofron tituj të ndryshëm lidhur me programin e studimit në fjalë. Me kërkesë të GVJ, institucioni vuri në dispozicion listën e titujve në gjendje në bibliotekë.

Nga një kërkim në faqen e internetit të bibliotekës - <http://library.unyt.edu.al/index.php>- me togfjalëshin "International law" rezultoi se titujt kryesorë të së drejtës ndërkombëtare si "Principles of Public International Law" e Ian Brownlie ose "Blackstones International Law Documents" e Malcom Evans gjenden në librari në disa kopje. Megjithatë, titulli më i ri nga kategoria "International Law" i përket vitit 2009. I njëjti konkluzion arrihet dhe nga një kërkim me togfjalëshin "Corporate Law": "The Anatomy of Corporate Law" i Reinier H. Kraakman është i vitit 2009. "International Trade Law" nga Indira Carr dhe Peter Stone është gjithashtu një botim i vitit 2010. Në mënyrë të ngjashme, "EU Law: Text, Cases, and Materials" nga Paul Craig dhe Grainne De Burca është një botim i vitit 2011, ndërkohë që botimi më i fundit i takon vitit 2015. Titulli "Intellectual Property Law: Text, Cases, and Materials" është i vitit 2013, ndërkohë që botimi më i fundit i takon vitit 2017. Këto janë disa shembuj që ilustron faktin që biblioteka është e pajisur me tituj që i vlejné programit të studimit, megjithatë jo gjithmonë këto tituj janë botimet më të fundit.

Nga një studim i listës së vënë në dispozicion nga institucioni dhe nga kërkimi në faqen e internetit të bibliotekës rezultoi se për disa lëndë të caktuara si p.sh *Civil Procedure, Fiscal Law, Private International Law*, disa ose një pjesë e mirë e teksteve të përcaktuara në syllabus nuk gjenden në bibliotekë. Për lëndë të tjera si p.sh *Dissertation seminar*, apo *Corporate Law* i një pjesë e mirë e teksteve gjenden në bibliotekë. Nga biseda me dy nga studentët e programit rezultoi se librat e caktuar në syllabus zakonisht gjenden në bibliotekë, pjesë të tyre mund të fotokopjohen, të tjerë mund të blihen.


Një ndër objektivat strategjike të Planit Strategjik 2018- 2022 është dhe investimi në infrastrukturë, posaçërisht në pasurimin e bibliotekës, rritje të aksesit në bibliotekat elektronike, përfshirje e stafit akademik në përditësimin e titujve të bibliotekës si dhe organizimi i vizitave në bibliotekë për të familjarizuar studentët me burimet ekzistuese.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:


- Listë e botimeve që ndodhet pranë bibliotekës, literaturë në lëndët e programit

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin</p>	<p>Që nga viti 2015 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme te Kodra e Diellit ku zhvillohet i gjithë aktiviteti akademik dhe administrativ. Ky kampus është në dispozicion të institucionit në tre vitet e fundit. Institucioni garanton mjedise të mjaftueshme dhe të pajisura për të përmbushur nevojat e mësimdhënies.</p>




<p>e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	
<p>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit në fjalë bibliotekën me ambiente leximi, tekste dhe materiale elektronike. Për disa lëndë të programit, literatura e detyrueshme gjendet në bibliotekë, ndërsa për lëndë të tjera jo. Përditësimi i titujve mbetet sfidë e vazhdueshme. Edhe pse biblioteka ka një larmi titujsh që i shërbejnë programit të studimit, një pjesë e mirë e tyre nuk janë të përditësuar dhe për rrjedhojë nuk reflektojnë zhvillimet më të fundit të debatit akademik. Gjithashtu vihet re një mungesë e përgjithshme e teksteve në shqip - më përjashtime të vogla - duke patur parasysh dhe rekomandimin e Këshillit të Akreditimit i cili kërkon që të vihet <i>"theksi më shumë në aspekte të ligjit dhe praktikës Shqiptare"</i>. Biblioteka u shërben studentëve në çdo ditë të javës.</p>
<p>Standardi V. 2 - Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparataturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Infrastruktura në përgjithësi lejon për një mbarëvajtje normale të aktivitetit mësimor dhe kërkimor. Institucioni vë në dispozicion të studentëve klasa, salla leksioni, bibliotekën, sallën e kompjuterit si dhe zyra për stafin administrativ. Mjediset mësimore janë të përshtatshme për zhvillimin e mësimdhënies.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>1. Që nga viti 2015 me zhvendosjen në kampusin te Kodra e Diellit, institucioni ofron infrastrukturë të qëndrueshme për veprimarinë mësimore, kërkimore dhe administrative për programin e studimit në fjalë. Gjithashtu institucioni garanton mjedise të mjaftueshme dhe të pajisura për të përmbushur nevojat e mësimdhënies.</p>	




2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e cila ofron tituj leximi në sallë dhe databazë elektronike. Për disa lëndë të programit në fjalë, literatura e detyrueshme nuk ofrohet në bibliotekën e IAL plotësisht për të gjitha lëndët e programit. Masa të vazhdueshme duhet të merren për përditësimin e fondit të bibliotekës si dhe pasurimin me tituj në shqip.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkimore

Pranë Institucionit është ngritur Zyra Financiare e ngarkuar me zbatimin e politikave financiare të institucionit dhe e përbërë nga 3 ekspertë. Zyra realizon procesin e menaxhimit financiar dhe informacioni që gjeneron Zyra shërben për vlerësimin e mënyrës së menaxhimit të institucionit, stabilitetit e qëndrueshmërisë së tij, etj. Sipas dokumentacionit të paraqitur nga institucioni, burimet kryesore të të ardhurave të tij janë kryesisht tarifat për dhe gjatë shkollimit në masën më të madhe të tyre dhe më pak grante për kërkim shkencor dhe kontratat për aktivitete tregtare (mensa, kafe, bar, rezidenca).

Për vitin 2017 vlerësimi i treguesve të matshëm është si më poshtë:


Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

Pushteti qëndror/vendor-	nuk ka
Fonde jopublike-	nuk ka
Grantet për kërkim dhe kontrata-	18,431,704
Konsulencat, shërbimet-	nuk ka
Tarifat për dhe gjatë shkollimit-	316,702,893
Sponsorizimet-	nuk ka
Shërbime trainuese etj-	nuk ka
Donacione etj -	nuk ka
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)-	81,834

Për vitet 2012-2016 të dhënat janë në Anekset e raportit. Nuk konstatohen ndryshime me të dhënat që janë paraqitur në RVB.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Sipas informacionit në institucion dhe atij të dorëzuar, veprimtaria e institucionit i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm që realizohet nga një kompani auditimi e certifikuar; në Raport paraqitet e gjithë situata financiare në përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të ofruara.
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Përveç auditimit të jashtëm realizohet edhe audit vjetor i brendshëm në lidhje me menaxhimin e të ardhurave, përmbushjen e qëllimeve të përdorimit të tyre etj., i cili realizohet nga një komision i emëruar nga Bordi i Aksionerëve të Institucionit. Në referim të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë burimet kryesore të të ardhurave janë kryesisht tarifat
Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në	




<p>funkcion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>për dhe gjatë shkollimit në masën më të madhe të tyre dhe më pak grante për kërkim shkencor dhe kontratat për aktivitete tregtare (mensa, kafe, bar, rezidenca). Sipas Raportit, drejtimet e shpenzimeve përqëndrohen në shpenzime për personelin, shpenzime konsumi dhe amortizimi, shpenzime të tjera shërbimesh, qera, kancelari, reklama, shërbime konsulence etj.</p>
<p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Universiteti i New York-ut në Tiranë, është hapur me anë të vendimit Nr. 397, datë 15.08.2002 i Këshillit të Ministrave si Shkollë e lartë Universitare dhe është transformuar në Universitet me VKM Nr. 448, datë 11.07.2012. Programi i studimeve Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare është hapur bazuar në Vendimin Nr. 939, datë 03.09.2009 të Këshillit të Ministrave, e akredituar me Urdhërin Nr. 170 datë 20.04.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionit të konsultuar Institucioni përpilon raporte të përvitshme financiare dhe në kushtet aktuale mund të thuhet se reflekton një qëndrueshmëri financiare që siguron për mbështetjen e programit të studimit Master Shkencor. Sidoqoftë perspektiva është e lidhur fort me numrin e studentëve që do ta zgjedhin Institucionin për të vijuar studimet Master, program i cili ndër vite ka pësuar një ulje të ndjeshme duke mbërritur në numrin 3 studentë për vitin akademik 2016-2017 dhe 7 studentë për vitin akademik 2017-2018.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Veprimtaria e institucionit i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm që realizohet nga një kompani auditimi e certifikuar; në Raport paraqitet e gjithë situata financiare në përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të ofruara. Përveç auditimit të jashtëm realizohet edhe audit vjetor i brendshëm në lidhje me menaxhimin e të të ardhurave, përmbushjen e qëllimeve të përdorimit të tyre, etj. i cili realizohet nga një komision i emëruar nga Bordi i Aksionerëve të Institucionit. 2. Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionit të konsultuar, Institucioni përpilon raporte të përvitshme financiare dhe në kushtet aktuale mund të thuhet se reflekton një qëndrueshmëri financiare që siguron mbështetjen e programit të studimit Master Shkencor. Sidoqoftë perspektiva është e lidhur fort me numrin e studentëve që do ta zgjedhin Institucionin për të vijuar studimet Master, program i cili ndër vite ka pësuar një ulje të ndjeshme në vite. 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

[Signature]

[Signature]

Sipas RVB (fq. 50) sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë “është institucionalizuar si strukturë organizative në UNYT nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të strukturave të përhershme, përmes Komisionit për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit (“Komisioni”) i cili siguron dhe monitoron cilësinë e mësimdhënies në bashkëpunim me Koordinatorin e Sigurimit të Cilësisë”. Në bazë të nenit 28 të Statutit të institucionit, ky Komision zgjidhet nga Senati Akademik dhe është përgjegjës për “koordinimin e procedurave për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të njësive akademike, kërkimit shkencor dhe të IAL”. Sipas nenit 29 të Statutit, Njësia e Sigurimit të Cilësisë “vlerëson në mënyrë periodike rezultatet e aktiviteteve mësimore dhe kërkimore.” Sipas të njejtit nen “në fund të çdo semestri ose përpara çdo provimi organizon vlerësimet e studentëve. Në bazë të ketyre pyetësorëve dhe informacionit të mbledhur kjo njësi përgatit raportin e vlerësimit vjetor”. Në bazë të nenit 29 të Statutit, kjo Njësi, së bashku me njësi të tjera administrative të Institucionit, vlerëson progresin e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Institucioni. Komisioni funksionon në bazë të Manualit për Sigurimin e Cilësisë që është hartuar nga vetë Komisioni dhe është i vitit 2018.

Në bazë të nenit 28 të Statutit, Komisioni përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë (por jo më shumë se 7), me një mandat dy vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Një nga anëtarët vjen nga radhët e studentëve. Aktualisht ky Komision përbëhet nga 7 anëtarë ndër të cilët: kryetarja e Komisionit, nga një përfaqësues nga secili Fakultet; një anëtar i jashtëm; një përfaqësues i studentëve; si dhe Koordinatorja e Zyrës së sigurimit të cilësisë. (Për më tepër, shih Tabelën 11) gjatë vizitës në institucion, GVJ pati një takim me Kryetaren e Komisionit, një anëtare si dhe Koordinatorin e Zyrës së sigurimit të cilësisë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

GVJ, në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, vë re se:

- a) Komisioni nuk ka hartuar një plan veprimi për procedurat e sigurimit të cilësisë;
- b) Komisioni nuk ka paraqitur raporte përmblledhëse të ecurisë së sigurimit të cilësisë. E thënë ndryshe, nuk ka “gjurmë” të aktivitetit të Komisionit, ose në rastin më të mirë ato ekzistojnë por nuk i janë vënë në dispozicion GVJ pavarësisht kërkesës;
- c) Konkluzionet e GVJ mbështeten mbi aktet rregulluese të institucionit dhe programit të studimit (Statut dhe Rregullore); informacioni i marrë gjatë vizitës; formularët e vlerësimit; raporti vjetor i monitorimit të departamentit për vitin 2017-2018; raporti vjetor 2017-2018 për institucionin; shembuj të raporteve të departamentit për kontrollin e transparencës së vlerësimit si dhe shembuj të peer review mes kolegësh.

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit

Sipas RVB (fq. 51) numri total i vlerësimeve nga studentët në programin e studimit në fjalë për periudhën 2012-2018 është 63. GVJ nuk disponon të dhëna sasiore gjithëpërfshirëse mbi anketimet që janë bërë me studentët për programin e studimit në fjalë. Megjithatë, gjatë takimit me përfaqësuesit e Komisionit u konstatua që vlerësimi nga studentët përmes pyetësorëve anonimë është një ndër mënyrat për sigurimin e cilësisë. Gjithashtu kjo u confirmua nga takimit me studentë të cilët pohuan se vlerësimi i lëndës ndodh në fund të çdo lëndë dhe organizohet në mënyrë anonime.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë bëhet nga Komisioni në bashkëpunim me organet e tjerat në institucion. Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me përfaqësues të Komisionit, GVJ u informua mbi mekanizmat për vlerësimin e cilësisë:

- 1) *peer evaluation* që është një vlerësim mes kolegësh;



- 2) vlerësimi i studentëve nëpërmjet pyetësorëve anonimë;
- 3) kontrolli i transparencës së vlerësimit që bazohet në kontrolle rastësore dhe ka për qëllim kontrollin e elementëve të vlerësimit;
- 4) fokus grupet që kanë për qëllim mbledhjen e komenteve nga studentët.

Përzgjedhja e lëndëve që i nënshtrohen kontrollit të transparencës së vlerësimit bëhet nga drejtuesi i departamentit në mënyrë rastësore dhe më pas reflektohet në një raport. Sipas Kryetares së Komisionit këto raporte dorëzohen në Departament dhe nëse ka probleme madhore, në Senat. Departamenti i diskuton këto çeshtje në mbledhje të dedikuara gjatë vitit dhe i pasqyron në raportin vjetor. Nga dokumentacioni i dosjes, GVJ shqyrtoi dy raporte departamenti të kontrollit të transparencës së vlerësimit, përkatësisht për periudhën semestri i vjeshtës 2017 (raport i dt. 5/4/2018, i pafirmosur) dhe semestrin e pranverës 2018 (raport i dt. 9/7/2018, i firmosur nga tre përfaqësues të Departamentit, Drejtuesja e Departamentit dhe Dekania e Fakultetit). Të dy raportet nuk evidentuan probleme.

Puna e Komisionit, bazohet në Manualin për Sigurimin e Cilësisë, i cili është një dokument përshkrues i parimeve të përgjithshme të sigurimit të cilësisë. Ky dokument përcakton Senatin akademik si organi akademik më i lartë që ka përgjegjësinë për miratimin, kontrollin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë. Manuali duhet të kondensohet më tej dhe të përmbledhë procedurat konkrete dhe ndarjen e roleve midis organeve në këto procedura. Në manual (fq. 14) del qartë që Komisioni harton një raport vjetor vetëvlerësimi institucional dhe të programit, por nuk përcakton më tej se ku paraqitet ky raport. GVJ nuk disponon asnjë raport të Komisionit për vetëvlerësimin institucional ose të programit.

Manualit për Sigurimin e Cilësisë i janë bashkëngjitur formularë të rishikimit të syllabus-ëve; peer – review të mësimdhënies; formularë vlerësimi nga studentët; model i raportit vjetor të departamentit. Megjithatë, Manuali nuk përcakton në mënyrë të qartë një plan veprimi të organizuar në kohë, organet përgjegjës dhe hapat që duhen ndjekur në rast se raportet evidentojnë probleme.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre


Raporti vjetor i monitorimit të departamentit për vitin akademik 2017-2018 u referohet vlerësimeve të studentëve "Like every year, the Law Department has continued to have anonymous student evaluation. [...] students have been incentivised to friendly speak with the lecturers, if they would have faced some informal problems by also proposing amicable solutions". Gjithashtu më tej në raport përmendet "The three young faculty members have been informally evaluated by the previous Head of Department [...]. The Law department has been satisfied with their performances. However, these evaluations should have been put in written evaluation forms. Peer evaluations for senior staff must also be performed next year. [...] All Student evaluations were conducted anonymously and their comments have been carefully considered."

Mund të konkludohet se vlerësimet e studentëve dhe nga stafi akademik janë mekanizma të përdorur për sigurimin e cilësisë. Megjithatë mungon informacion i detajuar lidhur me rezultatet e këtyre mekanizmave në rritjen e cilësisë.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:
- Annual Departmental Monitoring Report
 - Peer Evaluation of Teaching Samples
 - Report on Grading Fairness, Transparency, Comparability and Auditability

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
--------------------	-----------------------------




Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;

Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.

Të tërthorta:

- a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;
- b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;
- c. Pyetje konceptuale;
- d. Intervista;
- e. Etj.

Të drejtpërdrejta:

- a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.);
- b. Dëgjime në auditor;
- c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;
- d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;
- e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);
- f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;
- h. Etj.

Institucioni përdor metodologji vlerësimi për ecurinë e programit të studimit në fjalë. Këtu mund të përmendim metoda të tërthorta si vlerësimi i pedagogëve nga studentët dhe nga një koleg pedagog (peer review); marrja e mendimit të studentëve nëpërmjet fokus grupeve; kontrolli i transparencës së vlerësimit me studentët për çdo semestër.


“Raporti vjetor i monitorimit të departamentit” për vitin akademik 2017-2018 përmend vlerësimet e studentëve dhe faktin që komentet e tyre janë shqyrtuar me kujdes në rang departamenti, por nuk jepet më shumë informacion apo detaje lidhur me ndryshimet apo përmirësimet që mund t’i jenë bërë programit të studimit.

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;

Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.

Institucioni synon të sigurojë cilësinë e programit të studimit nëpërmjet një strukture të qëndrueshme si Komisioni për sigurimin e cilësisë. Komisioni bazohet mbi Manualin e Sigurimit të cilësisë, i cili përshkruan në mënyrë të përgjithshme parimet e sigurimit të cilësisë por nuk përmban një plan



	veprimi të mirëpërcaktuar lidhur me procedurat dhe hapat që duhet të ndërmerren gjatë vitit akademik nga aktorët e ndryshëm lidhur me kontrollin e brendshëm të sigurisë. Komisioni nuk ka paraqitur një raport vetëvlerësimi. Institucioni dhe departamenti kanë hartuar respektivisht një raport vetëvlerësimi për vitin 2017-2018.
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	Institucioni dhe Departamenti kanë hartuar dhe publikuar një raport vjetor për 2017-2018 ku vlerësohet ecuria e zhvillimit të institucionit dhe programit.
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programit të studimit në fjalë. Institucioni ka krijuar Komisionin e sigurimit të cilësisë si njësi të përhershme e ngarkuar me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo njësi vepron mbi bazën e një manuali, por që nuk përmban një plan veprimi të detajuar.</p> <p>Dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion dëshmon për ekzistencën e mekanizmave për kontrollin e sigurisë si vlerësimet e studentëve, vlerësimet mes kolegëve, kontrolli i transparencës së vlerësimit dhe fokus grupet.</p> <p>Megjithatë nuk ka një raport të Komisionit që evidenton aktivitetin e tij si njësi monitoruese. Nuk ka evidencë që Komisioni i sigurimit të cilësisë është përfshirë në aktivitetet monitoruese dhe që siguron hapat konkret me qëllim implementimin e masave si përgjigje ndaj kontrolleve të ndërmarra.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni përdor metodologji (të drejtpërdrejta dhe të tërthorta) për vlerësimin e ecurisë së programit të studimit në fjalë. 2. Institucioni dhe Departamenti përkatës publikojnë raporte vetëvlerësimi, por Komisioni i sigurimit të cilësisë nuk vepron mbi bazën e një plani veprimi si dhe nuk ka publikuar një raport vetëvlerësimi. 3. Institucioni dhe Departamenti kanë hartuar dhe publikuar një raport vjetor për 2017-2018 ku vlerësohet ecuria e zhvillimit të institucionit dhe programit. 4. Komisioni i sigurimit të cilësisë është krijuar si njësi e përhershme e ngarkuar me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo njësi vepron mbi bazën e një manuali, por që nuk përmban një plan veprimi të detajuar. Dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion dëshmon për ekzistencën e mekanizmave për kontrollin e sigurisë si vlerësimet e studentëve, vlerësimet mes kolegëve, kontrolli i transparencës së vlerësimit dhe fokus grupet. Megjithatë nuk ka një raport të Komisionit që evidenton aktivitetin e tij si njësi monitoruese. Nuk ka evidencë që Komisioni i sigurimit të cilësisë është 	

Josilva Pipa

[Signature]

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Në referim të objektivave të Programit të Studimeve Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare qëllimi i këtij edukimi është përgatitja e studentëve me njohuri të avancuara në fushën e të drejtës ndërkombëtare të asaj tregtare, avancimin e kërkimit shkencor në këto fusha me qëllim të ofrimit ndaj tregut të specialistëve të pajisur me njohuri e përgatitje të posacme në fushën e të drejtës ndërkombëtare dhe asaj tregtare.

2 degët në të cilat ofrohet studimi janë të një rëndësie të vecantë por me shtrirje jo të përshtatshme për të qenë të shkrira në një program studimi të thelluar. Në qasjen që ka përvec papërshtatshmërisë së realizimit të studimit në dy degë të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare ka dhe potencialin e mos ezaurimit të studimit të thelluar të asnjërës prej tyre.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare” përfshin:

- Qëllimin, objektivat e programit;
- Organizimin e tij sipas viteve/semestrave;
- * 1 (një) vit akademik ka – 28 javë mësimore në auditor;
- * 1 (një) semestër ka – 14 javë në auditor;
- * 1 (një) ECTS ka- 25 orë mësimore pune të studentit
- * 1 (një) orë mësimore- 60 minuta
- Plani mësimor i organizuar në lëndëve/moduleve për semester.

Në planin mësimor ngarkesa e lëndëve është e përcaktuar në bazë të numrit të krediteve sipas sistemit ECTS/ orë mësimore në auditor. Organizimi i krediteve është bërë sipas raportit: 1 kredit = 25 orë mësimore. Sipas planprogramit, lëndët me 8 kredite kanë 60 orë mësimore në auditor të cilat përfshijnë edhe orët e provimeve dhe 200 orë punë studimore; nga kjo rezulton se zbërthimi i kreditit është në masës 7.5 orë në auditor dhe pjesa tjetër orë jashtë auditorit. Mungon dallimi leksione seminare në përndjekje të modelit amerikan, por nuk ka as orë praktike.

Sipas të dhënave të dorëzuara nga ana e Institucionit shpërndarja e ngarkesës është si më poshtë: Leksione/Seminare -570 orë; Laborator (Metodat e Kërkimit në Ligj 'dhe' Seminar Disertacion -105 orë; Provimet (Të gjitha lëndët përveç, “Metodave të hulumtimit në ligj”, “Seminari i disertacionit” dhe Teza) - 38 orë; Detyra Kursi (e detyrueshme për kursin “Metodat e Hulumtimit në Ligj”)- 60 orë, për një total prej 773 orësh.

Përlllogaritja e orëve të provimit në ngarkesë duhet të mbajë parasysh që në 60 orë dhe 45 orë në auditore përkatësisht për lëndët me 8 dhe 6 kredite përfshihen edhe orët e provimeve të cilat janë llogaritur edhe një herë vetë. Gjithashtu, sipas akteve nënligjore, krediti është i përbërë nga orë në auditor, orë praktike, laboratorike dhe punë e pavarur studimi. Referuar planprogramit, lëndët me 8 kredite zhvillohen në 16 orë në javë. Sipas shpjegimeve të Institucionit, lëndët zhvillohen njëra pas tjetrës në intensitetin 16 orë në javë; rrjedhimisht 60 orë në auditor plotësohen në 3,75 javë. Ngarkesa e vitit të parë arrin në 26,5 javë.

Syllabuset për cdo lëndë kanë një model të ndjekur jo të gjitha rastet; përgjithësisht kanë të përbashkët elementët e emërimit të lëndës, viti e semestri i realizimit, emri i pedagogut/grupin e pedagogëve, njohuritë që i jep studentit, temat e programit, si edhe numrin e ECTS të lëndës. Ka syllabuse që nuk e kanë të evidentuar ngarkesën në orë në auditor dhe jashtë auditorit dhe janë jo të detajuara edhe në komponentë të tjerë të detyrimeve të studentëve apo karakterin e detyrueshëm apo më zgjedhje të lëndës.

Nga rishikimi me kujdes i syllabus-eve të lëndëve rezultojnë se tematikat e trajtuara nuk reflektojnë objektivat e lëndës, nuk trajtohen në mënyrë koherente ose dhe shpeshherë nuk lidhen me natyrën e programit të studimit. P.sh *Principles of International and Commercial Law* trajton këto tema: shteti, formimi i shteteve, sovraniteti dhe çështje të shteteve kombe, hyrje në politikën e përbashkët tregtare në Bashkimin Europian, njohja e shteteve dhe qeverive, sovraniteti territorial, subjektet dhe burimet e së drejtës ndërkombëtare, natyra e kushtetutave, shteti i së drejtës; parime të përgjithshme të të drejtave të njeriut, roli i parlamentit në politikën e përbashkët tregtare, elemente të kontratave tregtare, llojet e kontratave. Ka një mungesë të qartë koherence në temat e trajtuara në këtë lëndë. Gjithashtu, edhe nëse qëllimi i lëndës është të njohë studentët me konceptet bazë të tre degëve të së drejtës (e drejtë kushtetuese, e drejtë ndërkombëtare publike dhe e drejtë tregtare), temat e veçanta duhen trajtuar sipas një rendi logjik të shtjellimit të çështjeve.

Një ndër qëllimet e lëndës *Public International Law I* është të njohë studentët me bazat e së drejtës ndërkombëtare publike në nivele të ndryshme, me funksionimin e akteve legislative dhe organizatat ndërkombëtare. Ky qëllim nuk përputhet plotësisht me temat në syllabus ose së paku me temat që duhet të përmbajë një lëndë si e drejta ndërkombëtare publike. Syllabusi përfshin tema të së drejtës kushtetuese të krahasuar (si p.sh. koncepti i sovranitetit në SHBA, Britani të Madhe, Hollandë, Gjermani; koncepti i federalizmit në vështrim krahasues; pushteti legjislativ në vështrim krahasues; pushteti ekzekutiv në vështrim krahasues; rishikimi gjyqësor në vështrim krahasues) si dhe disa tema të së drejtës ndërkombëtare publike (si p.sh. organizatat ndërkombëtare; marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore). Pra, thënë ndryshe rreth gjysma e temave trajton çështje të së drejtës kushtetuese të krahasuar, që nuk përputhet me objektivat dhe titullin e lëndës, si dhe me qëllimin e programit të studimit.

Gjithashtu, *Public International Law II* është në fakt një shtjellim i temave të së drejtës europiane (institucionet dhe tregu i përbashkët), por titulli i lëndës është e drejtë ndërkombëtare publike gjë që nuk reflekton përmbajtjen e lëndës.


Për lëndën *International Trade Law* ka një mospërputhje midis përshkrimit të përmbajtjes së lëndës ("*This course is presented in two separate sessions and from two perspectives: First, the Institutions will be addressed, followed by the legal bases of international trade at level of WTO, EU and other trade blocks (e.g. ASEAN, MERCOSUR, NAFTA), providing the framework for international economic transactions [...]*") dhe temave të trajtuara të cilat fokusohen në transaksionin tregtar, institucionet tregtare, baza ligjore në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe Bashkimin Europian, kontratat e shitjes nën regjimin INTERCOMS etj. Syllabusi nuk përmban tema të cilat trajtojnë format e ndryshme të integritimit ekonomik si ASEAN, MERCOSUR, NAFTA ose të paktën këto nuk dalin qartësisht nga syllabusi. Si përfundim, syllabuset e disa lëndëve kanë nevojë të rishikohen thellësisht në mënyrë që të ofrojnë koherencë të brendshme dhe në lidhje me programin e studimit.

Në lidhje me literature, ka lëndë burimet e të cilave janë të pamjaftueshme në syllabusin e lëndës duke u kufizuar në vetëm 1 ose 2 burime; në përgjithësi burimet e literaturës në gjuhë të huaj dhe vendase pranë Bibliotekës së Institucionit duhen zgjeruar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të	Programi Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare është akredituar në vitin 2012. Programi është i organizuar në module të vlerësuara në kredite,

<p>Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); Ndarja e krediteve të Programit Master Shkencor në 2 vitet rezulton 56 me 64, (në Planprogramin e plotë të lëndëve duhen vënë të dhëna të plota në dy semestrat e vitit të 2të mbi numrin e lëndëve që zgjidhen dhe cilat janë lëndët me zgjedhje.) Duhet të observohet ndarja e barabartë e krediteve në 2 vitet sepse ndikon në mbartjen e numrit të krediteve në vitin pasardhës, duke rritur më shumë ngarkesën në vitin e dytë.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare” ka në fokus përgatitjen e studentëve me njohuri të avancuara në fushën e të drejtës ndërkombëtare, të asaj tregtare, avancimin e kërkimit shkencor në këto fusha me qëllim të ofrimit ndaj tregut të specialistëve të pajisur me njohuri e përgatitje të posaçme, njohuritë bazë të të cilave ofrohen në programin bachelor në drejtësi. Programi synon gjithashtu pajisjen e studentëve jo vetëm me njohuritë bazë shkencore dhe profesionale por edhe me shprehje të transferueshme dhe ndihmëse duke kontribuar në zgjerimin e mundësive për punësim në disa sektorë.</p> <p>Duke marrë në konsideratë edhe problematikën e shprehur më lart mbi përmbajtjen e programit, mund të thuhet gjithsesi se një bazë të vlefshme edukimi mund të arrihet për të vijuar thellimin e studimit në programet të ciklit të tretë në fusha të lidhura me të drejtën ndërkombëtare private.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të</p>	<p>Në vlerësim të parashikimeve të Rregullores së Programit</p>




<p>programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Master Shkencor mund të thuhet se përmbajtja dhe renditja e objektivave të programit të studimit synojnë arritjen e qëllimeve në mënyrë të përshtatshme me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato; sidoqoftë shtrijta e studimit në dy fusha të gjera të së drejtës si ajo e të drejtës ndërkombëtare dhe paralelisht e asaj tregtare e bën të vështirë dhe të papërshtatshëm studimin e avancuar të tyre.</p>
	<p>Gjithashtu, siç është përmendur dhe më lart, syllabus-et e lëndëve duhen rishikuar në mënyrë që të sigurohet koherenca e tyre e brendshme si dhe koherenca me programin e studimit në fjalë. Për shembull në lëndën <i>Principles of International and Commercial Law</i>, ka një mungesë koherence në temat e trajtuara në këtë lëndë. Gjithashtu, edhe nëse qëllimi i lëndës është të njohë studentët me konceptet bazë të tre degëve të së drejtës (e drejtë kushtetuese, e drejtë ndërkombëtare publike dhe e drejtë tregtare), temat e veçanta duhen trajtuar sipas një rendi logjik të shtjellimit të çështjeve. Gjithashtu, rreth gjysma e temave të lëndës <i>Public International Law I</i> trajtojnë çështje të së drejtës kushtetuese të krahasuar, që nuk përputhet me objektivat e temës dhe titullin e lëndës, si dhe me qëllimin e programit të studimit. (Për më shumë shembuj, shih shtjellimin më lart "<i>Vlerësimi i treguesve të matshëm</i>").</p>
	<p>Në lidhje me vlerësimin e studentëve, vlerësimet përfshijnë vlerësimin me anë të detyrave të kursit dhe provimeve përfundimtare, në disa lëndë edhe me vlerësime të pjesëshme. Përgjithësisht dominon vlerësimi që bazohet në ndarjen 40% detyrë kursi dhe 60% provim përfundimtar. Në lëndën 'Metodat e Kërkimit në Ligj' vlerësimi bazohet në vlerësimin në masën 80% të një detyrë kursi dhe 20% pjesëmarrje në klasë. Ndërsa në kursin '<i>Seminar disertacion</i>', mjetet e vlerësimit bazohen në seminarin e grupit dhe në hulumtimin individual i cili përmbillet me mbrojtjen me gojë të tezës. Është e paqartë si ngrihet komisioni i vlerësimit përfundimtar në një lëndë; nuk ka një procedurë formale të përcaktimit të një komisioni vlerësues në lëndë dhe gjithashtu të një sezoni të qartë datash provimesh.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e</p>	<p>Programi ka fokus në të drejtën ndërkombëtare dhe atë të BE-së por ka tipare që kanë nevojë të adresohen më përshtatshëm në lidhje dallimin e studimit të së drejtës ndërkombëtare me atë tregtare. Programi duhet të japë hapësirën e nevojshme të studimit ose të së drejtës ndërkombëtare ose të së drejtës ndërkombëtare tregtare. Në qasjen që ka përveç papërshtatshmërisë së realizimit të studimit në dy degë të ndryshme të së drejtës</p>

Janëllë Pipari


[Signature]

<p>transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara</p>	<p>ndërkombëtare ka dhe potencialin e mos ezaurimit të studimit të thelluar të asnjërës prej tyre.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi i studimit është i lidhur me profilin e Institucioni si Universitet në fushën e arsimit të lartë dhe objektivat në fushën e edukimit ligjor. Sidoqoftë kurrikula e programit duhet të forcohet në drejtim të elementëve që janë përmendur më sipër duke avancuar kërkimin në një drejtim ose në tjetrin që nënkupton përfshirjen në program të studimeve më të posacme në drejtim të së drejtës ndërkombëtare ose asaj tregtare. Duhet të thellohet studimi dhe humultimin në drejtim të instituteve të së drejtës ndërkombëtare apo asaj tregtare sipas profilit në njërën ose në tjetrën degë studimi që sugjerohet të zgjidhet të jetë fusha e studimit të programit. Sipas konsultimit në takime dhe informacionit në documentation, personeli akademik angazhohet aktivisht në punë kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve, për të ofruar nivelin më cilësor e të fundit në fushën përkatëse; spikasin aktivitetet në kuadër të Qendrës Kërkimore.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>N/A</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Institucioni ka disa rregullime për mënyrën e studimit të tregut të punës por nuk rezultojnë të ketë një studim të posacëm shkencor tregu të punës për këtë program apo në përgjithësi. Sipas informacionit të ofruar në Institucion, për përmirësimin e programit Master Institucioni fton shpesh edhe në formatin e Panairëve të Punës subjekte të ndryshme të tregut të punës për të vlerësuar kërkesat e pritshmëritë e tregut. Shpesh ka komunikime të drejtpërsëdrejta me përfaqësues të institucioneve në lidhje me përcjelljen e informacionit mbi programin dhe nxitjen e ndjekjes së tij nga personeli i tyre; fakt është që një pjesë e mirë e studentëve në programin Master janë të punësuar duke mundësuar vendosjen e këtij kontakti edhe nëpërmjet tyre.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	

Ilirija Pipari

[Signature]

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit që nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe mund të thuhet se në një përmirësim të standardeve sipas observimeve programi i studimit do të ndihmojë më shumë në zhvillimin e vlerave kulturore kombëtare të cilat përfshijnë edhe vlerësimin e njohjen e rregullimeve në fusha të reja të zhvillimit të së drejtës.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi realizohet me 120 kredite europiane ECTS; 30 kredite janë përcaktuar për objektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja e tyre është 2 vite akademike. Ndarja e krediteve të Programit Master është 56 kredite në vitin e parë dhe 64 kredite në vitin e dytë; siç është theksuar edhe më sipër duhet të observohet ndarja e barabartë e krediteve në 2 vite.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>N/A</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Nga takimet me studentët dhe konsultimit me informacionin që disponohet në Institucion rezultojnë se studentëve u ofrohet informacion lehtësisht i konsultueshem që përfshin mënyrën e organizimit të institucionit, programet që ofrohen, modulet dhe syllabuset, etj</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Rregullorat e programit Master shpjegojnë mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve, detyrime në lidhje me afatet, pasojat etj; 30 kredite janë përcaktuar për objektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>1. Programi realizohet me 120 kredite europiane sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); 30 kredite janë përcaktuar për objektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja e tyre është 2 vite akademike por ndarja e krediteve në 2 vitet rezultojnë 56 me 64.</p>	




2. Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programit të studimit synojnë arritjen e qëllimeve në mënyrë të përshtatshme me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato; sidoqoftë shtrirja e studimit në dy fusha të gjera të së drejtës si ajo e të drejtës ndërkombëtare dhe paralelisht e asaj tregtare e bën të vështirë dhe të papërshtatshëm studimin e avancuar të tyre. Programi duhet të japë hapësirë e nevojshme të studimit ose të së drejtës ndërkombëtare ose të së drejtës ndërkombëtare tregtare. Në qasjen që ka përveç papërshtatshmërisë së realizimit të studimit në dy degë të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare ka dhe potencialin e mos ezaurimit të studimit të thelluar të asnjërës prej tyre.
3. Institucioni ka disa rregullime për mënyrën e studimit të tregut të punës por nuk rezultojnë të ketë një studim të posaçëm shkencor tregu të punës për këtë program apo në përgjithësi. Sipas informacionit të ofruar në Institucion, për përmirësimin e programit Master, Institucioni fton shpesh edhe në formatin e Panairëve të Punës subjekte të ndryshme të tregut të punës për të vlerësuar kërkesat e pritshtmëritë e tregut.
4. Syllabus-et e disa lëndëve duhen rishikuar në mënyrë që të sigurohet koherenca e tyre e brendshme si dhe koherenca me programin e studimit në fjalë, si për shembull në lëndën "*Principles of International and Commercial Law*" apo "*Public International Law*". (Për më shumë shembuj, shih shtjellimin më lart "*Vlerësimi i treguesve të matshëm*").

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Rregullat e detajuara mbi programin e studimit përcaktohen në Rregulloren mësimore të programit të studimit. Sipas RVB, programi i studimit përfshin:

- Disiplina/lëndë të formimit të përgjithshëm (A):
Principles of International and Commercial Law;
Foundations of Postgraduate Studies;
Research Methods in Law.
- Disiplina/lëndë të formimit karakterizues të programit (B):
Public International Law I and Public International Law II;
Corporate Law I and Corporate Law II;
Private International Law.
- Disiplina/lëndë të ngjashme të lidhura me disiplinat e formimit karakterizues (C):
Fiscal Law;
Civil Procedures.
- Disiplina të tjera si intership, praktika: Dissertation Seminar
- Tema e diplomës.

Sipas RVB (fq. 79), programi i studimit "*nuk i ndan leksionet dhe seminarët. Të gjitha mësimet janë mësimet frontale dhe studentët mund të bashkëveprojnë direkt me ligjëruesit.*" Kjo formë interaktive e mësimdhënies u konfirmua dhe nga biseda me studentët e programit. "Metodat e Kërkimit në Ligj" dhe Seminari i Disertacionit zhvillohen në laborator. Në lëndën "Metodat e Kërkimit në Ligj" parashikohet dhe një detyrë kursi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:




- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Shih Tabelën 15)

Siç shihet dhe në Tabelën 15, format e mësimdhënies për këtë program studimi janë: leksione/seminare, laborator, provimet dhe detyrat e kursit. Siç u konfirmua dhe nga takimi me studentët, programi i studimit nuk ben dallim midis leksioneve dhe seminareve; mësimdhënia është interaktive.

- Format e kontrollit të njohurive (Shih Tabelat 16.1, 16.2, 16.3)

Format e kontrollit të njohurive varen nga lloji i lëndës, megjithatë parimi kryesor është ai i disa komponentëve në vlerësim. Kështu përshembull në lëndën Corporate Law I, vlerësimi është si vijon: prezantim 10%; frekuentim 10%; provim i pjesshëm 30%; provim përfundimtar 50%. Në lëndën Procedura Civile, vlerësimi bëhet si vijon: pjesëmarrja 20%; provim i pjesshëm 30%; provim përfundimtar 50%. Në lëndën E Drejta Fiskale vlerësimi bazohet në pjesëmarrje 10%; provim i pjesshëm 40%; provim përfundimtar 50%.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë (Shih Tabelën 18)

Sipas informacioneve të dhëna nga institucioni, 1 student është përfshirë në punimet shkencore individuale të lektorëve; 5 studentë në projektet shkencore në nivel departamenti; dhe 7 studentë në projekte shkencore në nivel fakulteti. GVJ nuk disponon të dhëna konkrete të këtyre përfshirjeve, por ky fakt u konfirmua dhe nga biseda me stafin akademik të cilët pohuan se studentët përfshihen në kërkimin shkencor të Departamentit kur p.sh tema e diplomës lidhet me fushën kërkimore te pedagogut. Në keto raste shihet mundësia e rishikimit të temës për t'u botuar (me emrin e studentit).

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:
- Code of Ethics


9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Në bazë të nenit 76 të Ligjit për Arsimin e Lartë, "pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë". Nga shqyrtimi i dokumentacionit vënë në dispozicion nga institucioni, nuk ka një dokument me kriteret e pranimit. Nga vizita në sekretarinë mësimore rezulton se dosjet e aplikimit të studentëve përmbajnë: formularin e aplikimit; diploma e shkolles së mesme; kopje e noterizuar e diplomës së ciklit të parë shoqëruar me listën e notave; dokument identifikimi; 2 foto; CV; dëshminë e një gjuhe të huaj; formulari i kodit të ndershmërisë akademike, formulari i ndihmës financiare. Studentëve që kanë mbaruar studimet në programe të huaja nuk u kërkohet dokument i aftësisë së gjuhës së huaj.

Në strukturën organizative të institucionit përfshihet dhe Zyra e Karrierës dhe e marrëdhënies me të diplomuarit si dhe studentët përfaqësohen në Këshillin Studentor. Zyra e Karrierës parashikohet në nenin 55 të Statutit të IAL. Sic u konfirmua dhe nga biseda me dy studentët e pranishëm, shumica e studentëve të programit master janë të punësuar gjatë kohës së studimeve. Megjithatë institucioni ka një zyrë karriere e cila mban marrëdhëniet midis punëdhënësve dhe studentëve. Sipas drejtuesit të zyrës së Karrierës, njoftimet për vende pune publikohen përgjithësisht online, në social media. Gjithashtu në muajin maj të cdo viti akademik



organizohet panairi i punës. Sipas drejtuesit të zyrës së karrierës, studentët e masterit në fjalë kanë një hezitim për të marrë pjesë në këtë panair pasi mund të ndeshen me punëdhënësin aktual. Gjithashtu prej dy vitesh në IAL organizohet një event për alumni.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, nuk është e mundur të identifikohen kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve për programin e studimit në fjalë. RVB (fq. 82) përmend si kriteret ato ligjore (diploma Bachelor, deshmimë e anglishtës) dhe dokumente të tjera si formularin e aplikimit, kopjen e pasaportës, 5 foto dhe një letër rekomandimi.

Numri i studentëve të regjistruar ka pësuar një ulje të konsiderueshme nga viti 2012-2013 (10 studentë të regjistruar) në vitin 2016-2018 (7 studentë të regjistruar) duke njohur uljen më të madhe në vitin 2016-2017 me 3 studentë. Nga bisedat në institucion u identifikua si arsye e mundshme një ngopje e tregut dhe zhvillimi i programit në gjuhën angleze.


Nga biseda me përfaqësuesen e Zyrës së Pranimeve rezultoi se IAL nuk ofron bursa të plota për programin master. U përmend që ka patur raste përjashtimi si p.sh studentit më të mirë të universitetit i është ofruar gjysëm burse për programin master; gjithashtu janë aplikuar ulje në tarifa për studentë që kanë ardhur në master nga brenda për brenda IAL.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Shih Tabelat 19 dhe 20)

Bazuar ne RVB si dhe, sipas informacionit të shqyrtuar nga GVJ në sekretarinë mësimore, rezultojnë këto të dhena:

- Ne vitin 2012-2013, 9 studentë të regjistruar në programin master me notë mesatare në hyrje 8.39. Nota mesatare në dalje ka qene 6.6. Nga këta, 2 studentë i kanë ndërprerë studimet.
- Ne vitin 2013-2014, 13 studentë të regjistruar ne programin master me notë mesatare në hyrje 7.35. Nota mesatare në dalje ka qenë 7.061. Nga këta, 2 studentë i kanë ndërprerë studimet dhe 1 studente pa numër matrikullimi i ka ndërprerë studimet gjithashtu.
- Në vitin 2014-2015, 6 studentë të regjistruar në programin master me notë mesatare në hyrje 8.11. Nota mesatare në dalje ka qene 8.21. Nga këta studentë, 1 është çregjistruar dhe 2 janë të padiplomuar ende.
- Ne vitin 2015-2016, 4 studentë të regjistruar në programin master me notë mesatare në hyrje 9.49 (më e larta e regjistruar). Nota mesatare në dalje ka qenë 8.03. Nga këta studentë, 3 janë të diplomuar dhe 1 është në pritje të temës së diplomës.
- Ne vitin 2016-2017, 3 studentë të regjistruar në programin master: nuk ka informacion për notën mesatare në hyrje. Nota mesatare në dalje ka qenë 9.23. Nga këta studentë, 2 janë diplomuar dhe 1 është në pritje të temës së diplomës.
- Në vitin 2017-2018, 7 studentë të regjistruar në programin master me notë mesatare në hyrje 8.77. Nuk ka informacion për notën mesatare në dalje.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). (Shih Tabelën 20)



Për vitin 2016-2017 janë diplomuar gjithsej 3 studentë me notë mesatare 9.23.

Të dhëna për punësimin e studentëve (Tabela 21)

Për programin e studimit master “E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare”, në lidhje me numrin total të të diplomuarve dhe numrin total të të punësuarve (në përputhje me diplomën) si dhe me numrin total të të punësuarve (jo në përputhje me diplomën) rezultojnë këto të dhëna të vëna në dispozicion nga institucioni:

- Për vitin akademik 2012-2013: 10 të diplomuar; 7 në përputhje me diplomën; 3 të punësuar jo në përputhje me diplomën;
- Për vitin akademik 2013-2014: 2 të diplomuar; 2 në përputhje me diplomën; 0 të punësuar jo në përputhje me diplomën;
- Për vitin akademik 2014-2015: 6 të diplomuar; 5 në përputhje me diplomën; 1 i punësuar jo në përputhje me diplomën;
- Për vitin akademik 2015-2016: 27 të diplomuar; 20 në përputhje me diplomën; 7 të punësuar jo në përputhje me diplomën;
- Për vitin akademik 2016-2017: 4 të diplomuar; 3 në përputhje me diplomën; 1 i punësuar jo në përputhje me diplomën.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

- Të dhëna për studentët e diplomuar, transferuar etj, në programin Master
- Arkiva e Diplomave prej 2012

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS; Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi; Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni; Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve; Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për	Studentët që kanë aplikuar dhe janë pranuar në këtë program studimi kanë përfunduar studimet e ciklit të parë “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite. Pranimi në këtë program studimi bëhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”. Megjithatë kriteret e pranimit nuk janë të normuara qartë në aktet bazë të IAL. Kriteri i gjuhës angleze (por edhe i gjuhëve të tjera të përcaktuara në ligj), është një kriter hyrës (bazuar në RVB dhe informacion nga vizita në IAL) dhe kërkohet nga ana e institucionit që në hyrje të studentëve.

Sanjush Pipari

[Signature]

ndryshimin e kriterëve të pranimit.	
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Shumica e studentëve në programin master janë të punësuar gjatë kohës së studimeve. Megjithatë studentët informohen për mundësitë e punësimit nëpërmjet Zyrës së Karrierës.</p> <p>Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit, akreditimin e programit të studimit, si edhe kanë këshillim karriere.</p>
Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna të plota në lidhje me studentët e regjistruar në program, ecurinë e tyre, tërheqjen apo transferimin. Ky informacion u konsultua lehtësisht në sekretarinë mësimore të IAL në prani të sekretares që është njëkohësisht dhe koordinatorja e programit master.</p>
Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Institucioni mban një bazë të dhënash për punësimin e të diplomuarve.</p>
Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të rregullt për programin e studimit, organizimin e tij. Nga bisedat me studentët u konfirmua ky fakt dhe u konstatua se midis studentëve dhe administratës/stafit akademik mbahen kontakte të afërta. Ky fakt lehtësohet sidomos nga numri i vogël i studentëve në programin master.</p> <p>Studentët informohen për vlerësimin e tyre. Neni 70 i Statutit të IAL parashikon se studentët mund të</p>

Spinalba Tupa

[Signature]

	përdorin procedurat e ankimit të vlerësimeve, megjithatë nuk duket se ka rregulla të detajuara (p.sh në Rregullore) lidhur me detajet e ketyre procedurave. Ekziston një formular për një petition/ankimim formal.
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;	IAL ndjek dhe këshillon vazhdimisht studentët në problematikat që ato hasin.
Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Praktika profesionale nuk parashikohet si pjesë e programit të studimit në master. Kjo mangësi do evidentohet dhe në rubrikën 11 të këtij raporti.
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. GVJ konkludon se studentët që kanë aplikuar dhe janë pranuar në këtë program studimi kanë përfunduar studimet e ciklit të parë “Bachelor” në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”. 2. IAL informon studentët lidhur me statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit. 3. IAL mban të dhëna lidhur me numrin e studentëve që ndjekin programin master. 4. Institucioni disponon të dhëna lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar. 5. Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programin master. 6. IAL ndjek dhe këshillon vazhdimisht studentët në problematikat që ato hasin. 	


KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

“Strategjia e Kërkimit Shkencor të IAL 2014-2017” dhe “Shtyllat Kryesore të Kërkimit për Qendrat dhe Departamentet në IAL (2018-2022)”, përbëjnë bazën e kërkimit shkencor në institucion dhe të programit master. Sipas Strategjisë së Kërkimit për 2014-2017 disa nga objektivat strategjike për kërkimin shkencor janë: rritje sasiore e kërkimit shkencor, rritje e kërkimit interdisiplinor në bashkëpunim dhe me institucione të tjera kërkimore, rritje e ndikimit të kërkimit dhe rezultateve në rajon dhe më gjerë si dhe mësimdhënie e bazuar në kërkim shkencor. Kjo strategji përcakton dhe metodat e matjes së produktit shkencor duke përfshirë: numri i granteve kërkimore, numri i monografive të botuara, numri i artikujve në revistat akademike me faktor impakti etj. Strategjia e Kërkimit Shkencor 2014-2017 përcakton objektivat kryesore të kërkimit dhe metodat/procedurat për përmbushjen e tyre, por nuk përmban një program kërkimi shkencor i cili reflekton fushat e kërkimit shkencor të stafit. Pra, më shumë se shtyllat kryesore të kërkimit sipas fushave/disiplinave përkatëse, Strategjia përcakton procedurat dhe metodën për matjen e produktit të kërkimit shkencor.




Shtyllat Kryesore të Kërkimit Shkencor (2018-2022) është një dokument i organizuar në bazë Fakulteti dhe përcakton kollonat kryesore të kërkimit. Për Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale shtyllat kryesore të kërkimit shkencor janë: 1) Demokracia dhe ndryshimet social-kulturore; 2) Integrimi Europian; 3) Globalizimi dhe politikat gjeopolitike. Stafit i përfshirë në mësimdhënie në masterin "E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare" nuk rezultojnë të jetë i përfshirë në shtyllat e kërkimit shkencor me projekte specifike. Disa anëtarë të Qendrës Kërkimore për Shkencat ("Qendra Kërkimore") Sociale janë të përfshirë me projektet e tyre në Shtyllat Kryesore të Kërkimit Shkencor për Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale.

Sic është përmendur dhe më lart, Fakulteti i Drejtësisë dhe shkencave Sociale ka në përberje një Qendër Kërkimore me 7 anëtarë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ zhvilloi një takim me një nga anëtarët e Qendrës. Sic u pohua gjatë bisedës, Qendra ka për qëllim të koordinojë të gjitha projektet kërkimore. Aktiviteti i saj bazohet në shtyllat e kërkimit të cilat janë rinovuar në vitin 2018. Pas aktivitetit vjetor, reflektohet mbi aktivitetet e Qendrës. Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, Qendra harton objektivat vjetore, përgatit një raport vjetor monitorimi. Këto plotësohen nga objektivat individuale për çdo anëtar të stafit akademik si dhe raportit i vlerësimit vjetor.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:


Të dhëna për kërkimin shkencor (Për më shumë shih Tabelat 22 dhe 23).

Tabela 22 pasqyron aktivitetet e planifikuara në nivel individual dhe institucional për pesë vitet e fundit, por nuk bën një ndarje të të dhënave për çdo vit duke e bërë të pamundur krahasimin e të dhënave ndër vite. Tabela 23 pasqyron aktivitetet e planifikuara në nivel individual dhe institucional në vitet e fundit për stafin akademik të programit master në fjalë por pa dhënë specifikime për vite të caktuara.

Sipas RVB (shih dhe Tabelën 22), personeli efektiv me orar të plotë i institucionit ka 112 botime në 5 vitet e fundit. Nga 9 projekte të fituara, 3 janë zbatuar. Institucioni ka zhvilluar 3 aktivitete shkencore. Sipas RVB (shih Tabelën 23), personeli efektiv i angazhuar në programin master në fjalë, ka 14 botime në vitet e fundit.

Bazuar në CV-të e personelit akademik (efektiv ose me kontratë) të programit të studimit në fjalë, gjendja është si më poshtë:


- A.G: 3 prezantime në konferenca ndërkombëtare; 1 kapitull libri;
- B.H: nuk ka informacion për publikime nga CV e vënë në dispozicion; gjithashtu nuk ka informacion në faqen e internetit të IAL;
- D.S: 13 prezantime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare; 2 publikime në *Hellenic Review of International Law*, 6 publikime në *Mediterranean Journal of Social Sciences*, 2 publikime në *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*; 3 publikime në *IUS& JUSTICIA*; 3 publikime në *Public Law Applications*.
- D.V: prezantime të shumta në konferenca ndërkombëtare si dhe publikime të shumta në revista ndërkombëtare, mes tyre dhe prestigjioze, si *Liverpool Law Review*, *Politica del Diritto*, *Journal of Law and Medicine* etj.
- E.O: 4 prezantime në konferenca kombëtare, 5 publikime në revistën juridike të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.
- E.K: 3 kapituj në librin "Public International Law" 2013 (të dhënat bibliografike për librin nuk janë të plota); 1 artikull në *Academicus International Scientific Journal*; 1 prezantim në një konferencë ndërkombëtare;
- H.R: 2 publikime;
- I.P: 6 publikime;
- J.Q: nuk ka prezantime në konferenca ose publikime;
- M.D: publikime të shumta por në fushën e studimeve gjinore, institucioneve, demokracisë, decentralizimi etj



- A.K: nuk ka prezantime në konferenca ose publikime;
- B.F: nuk ka prezantime në konferenca ose publikime;
- A.Zh: nuk ka prezantime në konferenca ose publikime.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Më shumë se gjysma e stafit të angazhuar në programin master “E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare” kanë publikime në revista shkencore kombëtare ose ndërkombëtare. Një pjesë e stafit nuk ka prezantime ose publikime.</p> <p>Një pjesë e publikimeve janë në revista prestigjoze, një pjesë tjetër në revista më pak të njohura dhe më një vizibilitet më të ulët.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Programi master “E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare” ofrohet në gjuhën angleze nga staf akademik që kanë kryer studimet në atë gjuhë ose që kanë njohje të avancuar të saj.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>IAL ofron mundësi mobiliteti të stafit akademik. Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion rezultojnë raste mobiliteti të stafit akademik të programit të studimit në fjalë.</p>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë</p>	<p>IAL disponon një bazë të dhënash për veprimtarinë kërkimore shkencore, pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e stafit akademik. Një burim i këtyre të dhënave janë jetëshkrimet e secilit anëtar të stafit akademik.</p>




personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Një pjesë e stafit akademik ka publikime në fushën përkatëse kërkimore dhe të mësimdhënies, të cilat janë me vlerë dhe për programin e studimit. Siç është vërejtur dhe më lart, për një pjesë të personelit akademik nuk ka të dhëna lidhur me publikimet apo prezantime në konferenca kombëtare ose ndërkombëtare. IAL duhet të marrë masa për përmirësimin sasior por dhe cilësor të output-it të kërkimit shkencor. Personeli akademik të inkurajohet të botojë në revista prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në fusha që lidhen me programin e studimit në fjalë. Në këtë mënyre kërkimi shkencor i shërben mësimdhënies.
2. Programi master “E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare” ofrohet në gjuhën angleze nga personel akademik i kualifikuar.
3. IAL i ofron mundësinë e kualifikimeve të vazhdueshme stafit akademik nëpërmjet vizitave kërkimore-shkencore ose periudhave të mësimdhënies në universitete të huaja.
4. IAL disponon një bazë të dhënash për veprimtarinë kërkimore shkencore, pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e stafit akademik.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Institucioni rezulton të ketë marrëveshje bashkëpunimi me Universitete publike e jo publike të rajonit e më gjerë në të cilat përfshihen shkëmbime dhe mobilitet edhe në drejtim të konsolidimit të ekspertizës akademike në fushat e përbashkëta të studimit. Mobiliteti i anëtarëve të personelit akademik por edhe i studentëve është i zhvilluar, nëpërmjet marrëveshjeve të lidhura me Universitete të huaja por edhe në kuadër të programeve Erasmus.

Institucioni ka lidhur marrëveshjeve me Universitete të huaja në rajon dhe Evropë, Indi etj. si University of Bolton, Selcuk University MUS Alparslan University Bilston Community College (BÇ) Science Po Rennes, France Paris Lodon University Salzburg, University Politechnica Bucharest, University of Genoa, University of Porto, Bulgarian Academy of Sciences etj.etj. Marrëveshje janë lidhur edhe me Universitete të tjera të themeluara nga i njëjti grup si Unveristy of New York Prague (UNYP), New York College Athens dhe New York College Thessaloniki.

Marrëveshje janë lidhur edhe me Universitete vendase si: Universiteti “Aleksander Moisiu” Durrës, Universiteti “Ismail Qemali” Vlore, Universiteti “Fan S. Noli” Korce, etj dhe me institucione shtetërore ka dhe me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme si edhe me subjekte të ndryshme brenda vendit për qëllime të realizimi të praktikës së studentëve por edhe të vendosjes së kontakteve për qëllime punësimi, si European Center Publication, Alpha Bank, etj A&D Busness Consulting, Dhoma e tregtisë dhe industrisë, STA qendra e testimit, etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Sipas të dhënave në RVB në lidhje me aktivitetet e zhvilluara:

Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte kombëtare a ndërkombëtare - 21


Numri i pjesëmarrësve në trainime, fushë kërkimi jashtë vendit - 6

Lëvizja e studentëve drejt dhe nga IAL-të - 31



Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Programi Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare nuk përfshin praktikë, një mangësi që u adresua edhe me përfaqësuesit e Institucionit. Në vlerësim të këtij observimi drejtuesit argumentuan mungesën e tij me target group të studentëve të programit të cilët janë të punësuar.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Institucioni reflekton një organizim efikas e bashkëpunues midis niveleve e strukturave të tij. Komunikimi midis stukturave e njësisve gjithashtu reflektonte ndarje funksionale të qartë e karakterizimin nga një frymë pozitive bashkëpunimi që u evidenua edhe në takimet për grupin e ekspertëve.</p> <p>Organizimi dhe funksionimin i sekretarisë së program Master, dhe disponimi i informacionit për studentët e programit është vecanërisht efikas dhe i vlerësueshëm.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka lidhur marrëveshjeve me Universitete të huaja në rajon dhe Evropë, Indi etj. si University of Bolton, Selcuk University MUS Alparslan University Bilston Community College (BC) Science Po Rennes, France Paris Lodon University Salzburg, University Politechnica Bucharest, University of Genoa, University of Porto, Bulgarian Academy of Sciences etj.etj. Marrëveshje janë lidhur edhe me Universitete të tjera të themeluara nga i njëjti grup si Unveristy of New York Prague (UNYP), New York College Athens dhe New York College Thessaloniki, me Universitete vendase si: Universiteti “Aleksander Moisiu” Durrës, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, etj dhe me institucione shtetërore ka dhe me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme si edhe me subjekte të ndryshme brenda vendit për qëllime të realizimit të</p>




praktikës së studentëve por edhe të vendosjes së kontakteve për qëllime punësimi, si European Center Publication, Alpha Bank, etj A&D Busness Consulting, Dhoma e tregtisë dhe industrisë, STA qëndra e testimit, etj.

Në takime u evidentua që institucioni mban kontakte të vazhdueshme me subjekte biznesi, organizata dhe përfaqësues të institucioneve në lidhje me përcjelljen e informacionit mbi programin dhe nxitjen e ndjekjes së tij. Panairi I punës gjithashtu zhvillohet në Institucion periodikisht me një interes të gjerë nga ana e studentëve.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare nuk përfshin praktikë, një mangësi që u adresua edhe me përfaqësuesit e Institucionit.
2. Institucioni reflekton një organizim efikas e bashkëpunues midis niveleve e strukturave të tij. Organizmi dhe funksionimin i sekretarisë së programit Master, ruajtja, depozitimi dhe disponimi i informacionit nga Sekretaria e Programit Master janë vecanërisht efikase dhe të vlerësueshme pozitivisht.
3. Institucioni ka lidhur marrëveshje me një numër të përshtatshëm Universitetesh të huaja në rajon dhe Evropë, Indi etj, Universitete vendase dhe organizata e institucione vendase. Institucioni mban kontakte të vazhdueshme me subjekte biznesi, etj. në lidhje me përcjelljen e informacionit mbi programin dhe nxitjen e ndjekjes së tij. Panairi i punës gjithashtu zhvillohet në Institucion periodikisht me një interes të gjerë nga ana e studentëve.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

- a) Të ndërtohet sa më shpejt një kampus për të patur një shkollë sa më cilësore por edhe me kushte normale për zhvillimin e mësimin.
- b) Të vihet theksi më shumë në aspekte të ligjit dhe praktikës Shqiptare, duke përfshirë një trajtim më të zgjeruar të ligjeve shqiptare të lëmive përkatëse si dhe praktikën e gjykatave.

Plotësimi i tyre nga Institucioni:

- a) Për rekomandimin “a)”, “Të ndërtohet sa më shpejt një kampus për të patur një shkollë sa më cilësore por edhe me kushte normale për zhvillimin e mësimin”, GVJ konstaton që institucioni zhvillon aktivitetin e tij në një kampus i cili përmbledh administratën, ambiente për zhvillimin e mësimdhënies, bibliotekën, laboratorë kompjuterikë. **GVJ konkludon se ky rekomandim është plotësuar.**
- b) Për rekomandimin “b)”, “Të vihet theksi më shumë në aspekte të ligjit dhe praktikës Shqiptare, duke përfshirë një trajtim më të zgjeruar të ligjeve shqiptare të lëmive përkatëse si dhe praktikën e gjykatave”, GVJ konstaton se disa nga lëndët e programit master si Civil Procedural Law, Company Law II, Fiscal Law, Private International Law trajtojnë, sipas specifikave të tyre, aspekte të ligjit dhe praktikës shqiptare. Duke patur parasysh natyrën e programit master në fjalë – me fokus në të drejtën ndërkombëtare - **GVJ konkludon se ky rekomandim është plotësuar.**




II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Institucioni ka një eksperiencë të vlefshme në drejtim të ngritjes dhe zhvillimit të programeve të cikleve të arsimit të lartë, eksperiencë e cila duhet të shërbejë si bazë e qëndrueshme për të arritur standardet e nevojshme për ofrimin e programit Master në ciklin e dytë të studimeve. Rugëtimi me Universitetin e Greenwich është gjithashtu një evidencë e eksperiencës në zhvillimin e programeve cilësore të arsimit të lartë.
2. Programi Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare ka një organizim dhe funksionim efikas të shërbimit sekretarik dhe atij koordinativ, duke siguruar mbarëvajtjen e proceseve dokumentore që lidhen me studentët dhe insitucionin. Mbështetja nga procese të mirëdokumentuara dhe efikase është e rëndësishme për arritjen e standardeve të nevojshme të cilësisë.
3. Në pozicionet drejtuese të institucionit dhe të njësive janë të angazhuar profesionistë me edukim dhe karrierë të gjerë në fushën akademike, edukim në universitete të huaja e në fusha të lidhura me të drejtën; qasja e tyre e hapur dhe mirëpritëse ndaj observimeve, qëndrimi bashkëpunës e konstruktiv është tregues i vullnetit dhe premisë e rëndësishme për përmirësimin e standardeve të programit.
4. Institucioni ka hapësira të bollshme, infrastrukturë të përshtatshme e të zhvilluar, auditore e salla laboratorike të bollshme, duke siguruar procese edukuese cilësore.

b. Pika të dobëta:

1. Programi Master ka një shtrirje të papërshtatshme nga ana metodologjike e studimit të dy degëve të gjera të së drejtës; asaj të së drejtës ndërkombëtare dhe të së drejtës tregtare. E drejta ndërkombëtare ka në fokus marrëdhëniet midis shteteve, rregullat dhe parimet e bashkëveprimit të shteteve dhe sistemeve juridike në nivelin mbikombëtar; e drejta tregtare është degë e së drejtës private dhe studimi i saj në fushën e së drejtës ndërkombëtare duhet të kishte saktësisht këtë përcaktim si në titull të programit (e drejtë nderkombëtare tregtare) ashtu edhe në përmbajtjen e tij. Studimi i dy degëve paralele asaj të së drejtës ndërkombëtare dhe asaj tregtare në mënyrën siç tenton ta ofrojë programi aktual është përveçse i papërshtatshëm por edhe i pamundur të realizohet.
2. Dekania e Fakultetit nuk është me titullin "Profesor" siç kërkon neni 42 i Ligjit për Arsimin e Lartë.
3. Vështirësia në gjetjen e personelit akademik vendas me grada e tituj dhe që njëkohësisht mund të zhvillojë mësimdhënie në gjuhën angleze ka ndikuar në mosplotësimin e kërkesave ligjore për angazhimin në programin Master të personelit akademik minimalisht me gradën shkencore "Doktor" e sipër. Programi ka titullarë lëndësh ose pjesë të ekipit të lëndëve personel pa gradën shkencore "Doktor" dhe në disa raste me 1-2 vite eksperiencë mësimdhënieje. Kjy fakt është shumë i ndjeshëm sidomos në 2-3 vitet e fundit akademike.
4. Programi mbështetet në pak orë në auditor duke ndikuar në gjerësinë dhe thellësinë e shqyrtimit të çështjeve në masën e përshtatshme për një nivel të avancuar studimi siç është ai i nivelit Master. Gjithashtu programi mbështetet vetëm në elementin leksion pa spikatje të elementëve të tjerë praktikë. Mosdallimi midis orëve leksion e atyre seminare si tipar i programeve të huaja nuk duhet të ndikojë në uljen e ngarkesës sado e dëshirueshme të jetë rritja e kërkimit e studimit të lirë nga ana e studentëve.
5. Një pjesë e titujve të detyrueshëm për lëndët nuk gjenden në bibliotekë. Gjithashtu, titujt ekzistues në bibliotekë dhe që i shërbejnë programit master nuk janë gjithmonë të përditësuar. Lista e titujve në shqip përgjithësisht është e varfër.
6. Edhe pse institucioni ka ngritur Komisionin për Sigurimin e Cilësisë si njësi të përhershme e ngarkuar me sigurimin e brendshëm të cilësisë, nuk ka evidencë për një plan pune të Komisionit, një raport vetëvlerësimi të këtij Komisioni si dhe hapat që pasojnë këto kontrolle.



7. Syllabuset e disa lëndëve nuk reflektojnë koherencë të brendshme si dhe nuk lidhen me objektivat e programit të studimit.

c. Mundësitë:

1. Mundësi aplikimi për grante kërkimore/mobilitet psh. në kuadër të BE.
2. Vendndodhja e institucionit në Tiranë pranë institucioneve shtetërore përbën një bazë shumë të mire për vendosjen e kontakteve me qëllim nisjen e praktikave mësimore.
3. Me hartimin e dokumentit “Shtyllat Kryesore të Kërkimit për Qendrat dhe Departamentet në IAL (2018-2022)” ekziston mundësia për krijimin e sinergjive në rang Fakulteti për përmirësimin e kërkimit shkencor dhe publikimeve nga stafi i programit master. Profili i programit master duhet të marrë vizibilitet më të madh në atë dokument.
4. Zhvillimi i programit në gjuhën angleze rrit mundësitë për përfshirje në programe shkëmbimi.

d. Pengesat:

1. Tendenca e numrit në ulje të studentëve që regjistrohen në programin master.


e. Rekomandime:

1. Rekomandohet që Institucioni, në rastin më të thjeshtë, të rishikojë emërtimin e programit master duke e ndryshuar në “E drejtë ndërkombëtare tregtare”. Nëse bëhet kjo, dhe programi/lëndët duhet të reflektojnë emërtimin e ri me fokus më të specializuar në të drejtën ndërkombëtare tregtare.
2. Rekomandohet që Institucioni të marrë masa për plotësimin e kërkesave ligjore dhe të vërë në dispozicion të programit master staf akademik minimalisht me gradën shkencore “Doktor” e sipër.
3. Rekomandohet që Institucioni të shtojë ngarkësen e lëndëve në auditor në mënyrë që të sigurohet një studim i thelluar i çështjeve në përputhje me nivelin e një programi master.
4. Rekomandohet që Institucioni të marrë masa për përditësimin e titujve në bibliotekë si dhe të sigurojë që të gjithë titujt për lëndët e detyrueshme të gjenden në bibliotekë. Gjithashtu biblioteka duhet të pasurohet me tituj në shqip për ato lëndë që i përkasin programit master.
5. Rekomandohet që Komisioni për Sigurimin e Cilësisë të hartojë një plan veprimi si dhe të pasqyrojë nëpërmjet raporteve të gjitha aktivitetet që ndërmer lidhur me sigurimin e cilësisë. Gjithashtu Komisioni duhet të sigurojë që në çdo rast shkeljesh të merren masa të cilat më pas reflektohen në raporte.
6. Rekomandohet që syllabuset (të evidentuara përgjatë raportit) të rishikohen thellësisht në mënyrë që të ofrojnë koherencë të brendshme në trajtimin e temave si dhe të reflektojnë më mirë objektivat/qëllimet e programit të studimit.
7. Rekomandohet që Institucioni të rrisë përfshirjen në aplikime për grante kërkimore dhe mobilitet.
8. Rekomandohet që Institucioni të përfshijë praktikat mësimore si pjesë e programit master.
9. Rekomandohet që Institucioni të marrë masa për përmirësimin sasior por dhe cilësor të output-it të kërkimit shkencor. Personeli akademik të inkurajohet të botojë në revista prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në fusha që lidhen me programin e studimit në fjalë.
10. Rekomandohet që Institucioni të angazhohet në një studim të vazhdueshëm të tregut të punës, të vazhdojë të organizojë takime me grupe të interesuar studentësh të ardhshëm dhe të angazhojë studentët e mëparshëm (alumni) me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programit duke reflektuar kërkesat e tregut të punës.

III. SUMMARY ANALYSIS OF THE EXTERNAL EVALUATION ACCORDING TO THE SWOT METHOD

a. Strengths:

1. The Institution has a valuable experience in setting up and developing higher education programmes. This experience should constitute the basis for meeting the necessary standards in the master



- programme International and Commercial Law. The former partnership with the University of Greenwich is evidence of this experience in developing qualitative programmes of higher education.
2. The master programme in International and Commercial Law is based on a well-functioning secretariat and coordinating unit that ensure the existence of appropriate documentation on student data and the institution. This is important aspect in meeting with the necessary quality standards.
 3. Leading positions in the institution and respective units are held by staff qualified in universities abroad and those with a long and well-established career in academia. Their open minded approach towards observations, and their cooperative and constructive attitude is an indicator of the willingness in improving the standards of the programme.
 4. The Institution provides for the necessary infrastructure, lecture halls and classrooms which overall contribute to the quality of the educational programme.

b. Weaknesses:

1. The approach taken in the master programme, namely the study of both international law and commercial law, is not suitable from a methodological point of view. International law focuses on relations between states, principles governing the interaction between states and legal orders at international level; commercial law is a branch of private law and the study of this branch of private law from an international law perspective should have been reflected in the title of the programme (International commercial law) and in its content. The study of two parallel areas of law (international law and commercial law), as offered by the programme, is inappropriate and impossible to be achieved.
2. The Head of the Faculty does not hold the "Professor" title, as requested by the article 42 of the Higher Education Law.
3. The difficulty on finding academic staff with the necessary academic qualifications and with the ability of teaching in English has caused the non-compliance with law requirements according to which academic staff teaching in the master programme must hold, as a minimum, a doctoral degree. Academic staff in charge of specific courses do not have a doctoral degree and in some cases they have 1-2 years of teaching experience. This fact is evident especially in the last 2-3 years.
4. The master programme is based on few auditorium hours and this has an impact on the breadth and depth of addressing issues at an advanced level as required by a master programme. In addition, the programme is based only on lectures without including other practical elements. The lack of distinction between lectures and seminars should not impact the study load despite the desirability of increasing individual research by students.
5. Some of the mandatory readings are not available in the library. In addition, existing literature is not always up to date. Lastly, the list of books in Albanian is generally poor.
6. Despite the fact that the Institution has set up the Commission for Quality Assurance as a permanent unit in charge of ensuring quality control, there is no evidence that the Commission has adopted an action plan, a self-evaluation report and a procedure with steps as follow up to its findings.
7. Syllabi of some courses are not developed in a coherent manner and do not reflect the objectives of the study programme.

c. Opportunities:

1. Opportunities for grant applications for research/mobility, e.g. in the context of the European Union.
2. The location of the Institution in Tirana in the proximity to state institutions represents a very good opportunity for establishing contacts in order to include professional practices as part of the study programme.
3. The document "Main Pillars of Research for Scientific Centers and Departments (2018-2022)" offers a good opportunity for creating synergies at the Faculty level in order to improve the level of research and publications by academic staff. The master programme International and Commercial Law should gain higher visibility in that document.
4. English, as the language of the programme, increases possibilities for setting up exchange programmes.



d. Threats:

1. There is a decline in the number of students who register for the master programme.

e. Recommendations:

1. It is recommended that the Institution adjusts the title of the master programme into "International commercial law". If this approach is taken, the new title should be reflected in the content of the programme and in a more specialized focus on international commercial law.
2. It is recommended that the Institution takes measures in order to comply with law requirements and that it includes academic staff with a doctoral degree.
3. It is recommended that the Institution increases auditorium hours in order to ensure an in-depth engagement with issues at an appropriate level for the master programme.
4. It is recommended that the Institution takes measures in order to update existing literature as well as to make sure that all mandatory readings can be accessible in the library. In addition, the library should contain more literature in Albanian that is linked to the master programme.
5. It is recommended that the Commission for Quality Assurance adopts an action plan and reflects in a report all its activities and measures taken in the context of quality assurance.
6. It is recommended that syllabi (as pointed out in the report) are revised accordingly so that they cover the different topics in a coherent manner and better reflect the objectives of the study programme.
7. It is recommended that the Institution increases its participation in applications for research and mobility grants.
8. It is recommended that the Institution includes professional practices as part of the study programme.
9. It is recommended that the Institution takes measures for the improvement of quantity and quality of research output. Academic staff should be encouraged to publish in prestigious national and international legal journals and in areas of law related to the study programme.
10. It is recommended that the Institution continuously performs an analysis of the job market and that it organizes meetings with future interested students and in addition, include an input from alumni in order to constantly improve the programme by reflecting the needs of the job market.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Evis Alimehmeti
2. Dr. Darinka Piqani

